



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti

Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË 2013

Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian nëpërmjet
Instrumentit të Ndhmës së Para-aderimit për
Shoqërinë Civile (IPA CSF)



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve".

Partner kryesor:

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2

1000-Shkup

Maqedoni

Tel.: + 389 (0)2 614 42 11

E-mail: executiveoffice@balkanicsd.net

Website: www.balkanicsd.net

Partner zbatues në Shqipëri:

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,

Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,


Kutia Postare (PO Box) 2418/1

Tel.: +355 4 2254881 Fax: +355 4 2254883

Email: partners@partnersalbania.org

<http://www.partnersalbania.org>

Botuar në Shqipëri, në Shkurt 2014



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK



Acquis e Shoqërisë Ballkanike

Fuqizimi i Advokacisë,

Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve

Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË 2013



Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



“Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, dhe Olof Palme International Center në Shqipëri nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian, Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze.”

Drejtuese

Juliana Hoxha

Grupi i Vëzhgimit

Kostandina Keruti

Adela Bani

Maris Selamaj

Edit Lako

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Elona Kapexhiu

Juliana Hoxha

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha

Klotilda Tavani Kosta

Kostandina Keruti

ISBN: 978-9928-08-140-7

Dizajni grafik:



Arben Hamzallari

Printimi:

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	6
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri.....	6
Gjetjet Kryesore	7
Rekomandimet Kryesore Politike.....	7
Rreth projektit dhe Matricës	8
Hyrje.....	9
Rreth Raportit të monitorimit	9
Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	9
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZSHHC) në Shqipëri	9
Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri	12
Mirënjohje dhe falenderime	13
Metodologjia.....	14
Përmbledhje e përfaqësues metodologjike	14
Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve	15
Mësimet e nxjerra	16
Gjetje dhe Rekomandime.....	17
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive.....	17
Nën-fusha 1.1.: Liria e organizimit	17
Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera.....	20
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të	22
Nën-fusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.....	22
Nën-fusha 2.2.: Mbështetja e shtetit.....	25
Nën-fusha 2.3.: Burimet njerëzore	27
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC.....	28
Nën-fusha 3.1.: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim.....	28
Nën – fusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes.....	29
Nën-fusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve	31
Gjetjet dhe Rekomandimet (Tabela)	33
Shtojca 1 Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në gjuhën shqipe.....	50
Shtojca 2 Përfaqësuesit e panelit të ekspertëve	51
Shtojca 3 Pyetëtori i OSHC-ve	52

Përmbledhja ekzekutive

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri

Zhvillimi i sektorit të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri ka qenë i lidhur me nisma dhe ndryshime ligjore të cilat janë përpjekur të krijojnë një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Në lidhje me lirinë e organizimit, Shqipëria ka një kuadër ligjor, sipas të cilit çdo person ka të drejtë të themelojë shoqatë, fondacion dhe qendër për çfarëdo qëllimi të lejuar nga ligji. Centralizimi i procesit të regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës përbën një barrë administrative dhe financiare për individët dhe personat juridik nga jashtë Tiranës për të regjistruar një OSHC. Përpos kësaj, procedurat financiare të raportimit janë të rregulluara me ligj, por rregullat e raportimit financiar dhe të kontabilitetit nuk janë efektive dhe të përshtatshme për OSHC-të. Ato nuk marrin në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve dhe nuk janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin /fushat e aktiviteteve të veprimtarisë së saj (ekonomike dhe jo-ekonomike).

Sfida kryesore për OSHC-të mbetet legjislacioni fiskal. Nuk ka përfitime tatimore për burime të ndryshme të ardhurash të OSHC-ve dhe ekziston një konfuzion në kuadrin ligjor lidhur me përjashtimin e granteve nga tatimi, duke çuar në interpretime të ndryshme në praktikë. Regjimi aktual fiskal cënon rolin e sektorit të shoqërisë civile duke mos bërë asnjë diferencim midis organizatave jo-fitimprurëse dhe organizatave fitimprurëse. Ai pengon aktivitetin e OSHC-ve, sidomos në fushat e ofrimit të shërbimeve dhe krijon ngarkesa të panevojshme administrative për aktivitetin e tyre. Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal (gjatë vitit 2008, ai ka ndryshuar tre herë) janë

shoqëruar me vështirësi nga ana e sektorit për ta ndjekur dhe zbatuar atë. Paqartësia në trajtimin fiskal të OSHC-ve krijon hapësira për presion nga ana e qeverisë, siç ka qenë rasti i viteve të fundit me grupet advokuese, kritike ndaj punës së qeverisë. Financimi publik ka qenë i disponueshëm vetëm për tre vitet e fundit nëpërmjet agjencisë shtetërore Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), e cila nuk mbështet zhvillimin institucional të OSHC-ve dhe bashkë - financimin e projekteve të BE-së. Grantet dhe mbështetja jo-financiare janë të limituara dhe të vlefshme vetëm nga bashkitë e mëdha.

Nuk ka dokumenta strategjikë kombëtarë mbi marrëdhënien shtet-OSHC dhe zhvillimin e shoqërisë civile, shoqëruar kjo edhe me mungesën e strukturave dhe mekanizmave me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve. Konsultimet midis shtetit dhe OSHC-ve janë sporadike, më shumë në nivel informativ dhe si rezultat të paefektshme, të karakterizuara nga mungesa e procedurave standarte dhe rregullave të detyrueshme për t'u angazhuar në një dialog domethënës dhe të herëpashershëm me shoqërinë civile. Sipas legjislacionit ekzistues në vend, OSHC-të mund të konkurrojnë për kontrata shtetërore në kushte të barabarta me ofruesit e tjerë dhe nuk ka pengesa ligjore për OSHC-të të marrin fonde publike për ofrimin e shërbimeve të ndryshme përmes procedurave të prokurimit. Por, në praktikë OSHC-të nuk janë në gjendje të marrin kontrata në konkurrencë me ofruesit e tjerë për shkak të mungesës së rregullave dhe procedurave të qarta dhe mungesës së kapaciteteve të institucioneve publike për kontraktimin e OSHC-ve.

Gjetjet Kryesore

Nr	6 nga gjetjet kryesore të studimit	Referenca	
1	Raportimi financiar dhe rregullat e kontabilitetit nuk janë efektive dhe të përshtatshme për OSHC-të. Ato nuk marrin në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve dhe nuk janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj (ekonomike dhe jo-ekonomike).	Fusha	1
		Nën-Fusha	1.1
2	Nuk ka përfitime tatimore për burime të ndryshme të të ardhurave të OSHC-ve. Ka konfuzion në kuadrin ligjor në lidhje me përjashtimin e granteve nga tatimi, që sjell interpretime të ndryshme në praktikë.	Fusha	1
		Nën-Fusha	2.1
3	Statusi për Përfitimin Publik rregullohet përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe përfshin vetëm një numër të kufizuar të fushave të veprimit të OSHC-ve (vetëm tre fusha).	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.1
4	Financimi publik është bërë i mundur gjatë tre viteve të fundit përmes agjencisë shtetërore "Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" (AMSHC). Ajo nuk mbështet zhvillimin institucional të OSHC-ve dhe bashkë – financimin e projekteve të BE-së. Grantet dhe mbështetja jo-financiare janë të limituara dhe vihen në dispozicion vetëm nga bashkitë e mëdha.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.2
5	Nuk ka dokumenta kombëtarë strategjikë që kanë të bëjnë me marrëdhëniet shtet-OSHC dhe zhvillimin e shoqërisë civile, shoqëruar kjo me mungesën e strukturave dhe mekanizmeve me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.1
6	Sipas kuadrin ligjor, OSHC-të mund të konkurrojnë për kontrata shtetërore në baza të barabarta me ofruesit e tjerë dhe nuk ka pengesa ligjore për OSHC-të të marrin fonde publike për ofrimin e shërbimeve të ndryshme përmes procedurave të prokurimit. Por, në praktikë OSHC-të nuk janë në gjendje të marrin kontrata në konkurrencë me ofruesit e tjerë për shkak të mungesës së rregullave dhe procedurave të qarta dhe mungesës së kapaciteteve të institucioneve publike për kontraktimin e OSHC-ve.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.3

Rekomandimet Kryesore Politike

Nr	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë	Referenca	
1	Përshtatja e raportimit dhe rregullave financiare të përshtatshme, duke marrë parasysh natyrën specifike të OSHC-ve, madhësinë e organizatës dhe llojin e saj / qëllimin e aktiviteteve (ekonomike dhe jo-ekonomike).	Fusha	1
		Nën-Fusha	1.1
2	Sqarimi i përjashtimit të granteve nga skema e taksave përmes ligjit.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.1
3	Statusi për Përfitimin Publik (SPP) duhet të adresohet në kuadrin ligjor dhe jo përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i SPP duhet të zgjerohet dhe jo të lidhet vetëm me përjashtimin nga TVSH. Fushat e aktiviteteve të mbuluara nga SPP duhet të zgjerohen për të reflektuar diversitetin e aktiviteteve nga OSHC-të.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.1
4	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), mekanizmi kombëtar që siguron mbështetje publike për OSHC-të duhet të ristrukturohet, dhe duhet të luajë rolin e saj në përputhje me legjislacionin për të siguruar fonde për zhvillimin institucional të OSHC-ve, bashkë-financimin e granteve të BE-së dhe granteve të tjera, si dhe mbështetja jo-financiare.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.2
5	Hartimi i dokumenteve kombëtare që kanë të bëjnë me marrëdhënien shtet - OSHC, e cila përfshin qëllime, masat si dhe fonde në dispozicion dhe ndarjen e qartë të përgjegjësisë të zhvilluara në konsultim me OSHC-të.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.1
6	Vendosja e rregullave dhe procedurave të qarta përmes të cilave OSHC-të mund të kontraktohen për të ofruar shërbime nga autoritetet shtetërore. Prezantimi dhe rregullimi me ligj i prokurimit social.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.3

Rreth projektit dhe Matricës

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të “Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike- Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve” projekt ky i financuar nga BE dhe Balkan Trust for Democracy (BTD). Ai është i pari i llojit të tij që publikohet në baza vjetore për zgjatjen e projektit të paktën 48 muaj. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZHSHC) zhvilluar nga BCSDN dhe ECNL. Ai është pjesë e një serie raportimesh vendore që mbulon 8 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë¹. Gjithashtu është i disponueshëm një Raport rajonal Monitorimi i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standartet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues

për veprimtarinë e OSHC-ve. Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha: (1) Garancitë Themelore Juridike të Lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të; (3) Marrëdhënia Qeveri-OSHC. Parimet, standartet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin e zhvillimit dhe diversitetin e vendeve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe në praktikatat rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të funksionojë e të zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist i cili të mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimit praktik të tij.

1) Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia and Turqia.

Hyrje

Rreth Raportit të monitorimit

Si pjesë e nismës “Acquis e Shoqërisë Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve”, Partnerët Shqipëri realizoi raportin kombëtar të monitorimit bazuar në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Qëllimi i këtij raporti monitorues është që të japë një përmbledhje të çështjeve që janë të rëndësishme për mjedisin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri si dhe rekomandime se si këto çështje mund të adresohen dhe të zgjidhen.

Ky raport monitorimi i përgatitur nga Partnerët Shqipëri bazohet mbi një hulumtim të legjislacionit shqiptar, analizave, politikave dhe raporteve; panelit të ekspertëve; studimit dhe intervistave të thelluara me OSHC-të për të vlerësuar indikatorët ligjor dhe praktikë të Matricës dhe të japë një panoramë mbi mjedisin në të cilin operojnë organizatat e shoqërisë civile.

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Objektivi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i themeleve për monitorimin dhe advokacinë mbi çështjet e lidhura me mjedisin mundësues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel rajonal dhe vendor si edhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikën e BE dhe procesin e aderimit në nivel European dhe vendor.

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis e Shoqërisë Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve” financiar nga BE dhe nga Balkan Trust for Democracy (BTD).

Ky Raport Monitorimi është i pari i llojit të tij që publikohet brenda vitit ndërkohë që projekti zgjat të paktën 48 muaj. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZHSHC) hartuar nga BCSDN dhe ECNL. Ajo është pjesë e një serie raportimesh vendore që mbulon 8 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë². Gjithashtu është i disponueshëm një Raport rajonal Monitorimi i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standartet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se

mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm, nga faza e zhvillimit të shoqërisë dhe nga sektori i shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon të përfshijë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues. Më tepër ajo thekson ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishme për vendet në të cilat ata kanë kryer veprimtarinë e tyre. Megjithatë, standartet janë

Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

2) Shqipëria, Bosnja dhe Herzegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia and Turqia.

formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato janë hartuar nga eksperiencat e OSHC-ve të këtyre vendeve në termat e mjedisit ligjor si edhe praktikës e sfidave në zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standarteve dhe indikatorëve është realizuar duke marrë në konsideratë liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht si edhe praktikën më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat zhvillohen më tej sipas standarteve specifike. Nga ana e tyre, standartet shpjegohen më tej përmes indikatorëve, në mënyrë që t'i japin OSHC-ve lokale, donatorëve apo palëve të tjera të interesuara mundësinë për të parë e monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikën e aplikimit të tij.

Përpunimi i Matricës së Monitorimit mbi mjedisin mundësues për ZHSHC-në, ishte pjesë e një përpjekje të përbashkët të ekspertëve të OSHC-ve dhe praktikuesve nga rrjeti i anëtarëve e partnerëve të BCSDN dhe me ekspertë e mbështetje strategjike nga ECNL. Skuadra me 11 anëtarë ekspertë përfshiu një mori njohurish e eksperiencash nga OSHC dhe organizata jofitimprurëse, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe përfshinte ekspertë nga 10 vende të Ballkanit. Puna me Matricën përfshiu takimet e punës si edhe punën on-line nga ekspertët, e cila u shqyrtua më tej nëpërmjet fokus-grupeve të aktorëve si edhe konsultimeve publike. Puna mbi përpunimin e Matricës u mbështet nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL brenda Programit të Mjedisit Mundësues Ligjor (LEEP)/Grantit të Inovacionit Ligjor dhe Balkan Trust for Democracy (BTD)

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZHSHC) në Shqipëri

25 vjet pas regjistrimit të OSHC-së së parë në Shqipëri, ende nuk ka një të dhënë zyrtare nga Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë (i vetmi autoritet shtetëror përgjegjës për regjistrimin e OSHC-ve në vend) mbi numrin e përgjithshëm të OSHC-ve të regjistruara. Sipas INSTAT numri i përgjithshëm i OSHC-ve në Shqipëri

është 1858 ku 141 prej tyre janë organizata të reja të regjistruara në vitin 2012. Ndërsa sipas Njesisë së Inteligjencës Financiare, gjatë vitit 2010, janë regjistruar një numër prej 1651 OSHC në organet tatimore në Shqipëri³. Përsa i përket formës së regjistrimit, në Raportin e Vlerësimit të Nevojave nga Zyra e TACSO Shqipëri në vitin 2011 raportohet se ka 2231 **shoqata** të regjistruara, 311 **fondacione** dhe 522 **qendra** në Shqipëri. Dhe nga këto, në bazë të vlerësimeve të TACSO, vetëm 450 OSHC janë aktive në gjithë vendin.

Gjatë tre dekadave të fundit zhvillimi i sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri ka patur larmishmëri në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve. Krahasuar me periudhën e parë të themelimit të tyre (1990 - 2000), periudhë në të cilën OSHC-të ishin fokusuar kryesisht në ofrimin e ndihmës për njerëzit dhe grupet e pafavorizuara, edukimin publik, promovimin e të drejtave të njeriut, të drejtave të grave, etj., në ditët e sotme shoqëria civile në Shqipëri ka një përfaqësim të lartë të grupeve qytetare, organizatave për të drejtat e njeriut, grupeve të ekspertëve dhe zhvillimin e kapaciteteve të fokusuar më tepër në advokim sesa në ofrim shërbimesh. Ky rol i sektorit është nxitur dhe ushqyer nga zhvillimet në vend, si dhe me strategjitë e donatorëve ndërkombëtarë dhe prioritetet e zhvillimit (kryesisht marrëdhënia dypalëshe e qeverisë).

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, shumica e OSHC-ve në Shqipëri kanë qendrën dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonat urbane, me një përqendrim në Tiranë (kryeqytet), dhe qytetet e mëdha në veri, qendër dhe jug, si Shkodër, Elbasan dhe Vlorë. Në një raport të vlerësimit të përgatitur nga IDM në 2012 "*Shoqëria Civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri*", është raportuar se sektori në zonat e thella rurale është ende në fazën e tij embrionale, numri i OSHC-ve është i ulët, misioni dhe objektivat e tyre nuk janë të fokusuar në mënyrë të qartë, dhe veprimtaria e tyre është modeste dhe shpesh sporadike. Si rezultat, ndikimi i tyre në komunitet është i ulët. Fusha e tyre e aktivitetit është e përqendruar kryesisht në advokim dhe lobim për grupe të veçanta të interesit, si të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, ruajtjen dhe promovimin

3) Sipas ligjit Shqiptar, OSHC-te duhet të regjistrohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, e cila mban regjistrin e OSHC-ve, si dhe tek autoritetet tatimore në vendet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

e kulturës dhe traditës së zonës, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e turizmit dhe promovimin e grupeve të ndryshme profesionale.

Zhvillimi i sektorit të OSHC-ve në Shqipëri është i lidhur me ndryshime dhe nisma ligjore me qëllim për të krijuar një mjedis mbështetës për OSHC-të. Ky proces ka filluar me miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë në vitin 1991, duke siguruar bazën ligjore për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve, e ndjekur nga një paketë ligjore funksionale, duke përfshirë Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr 8750, dt 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr 8781, dt 3.5.2001) që ofron bazën ligjore për regjistrimin dhe funksionimin e fondacioneve, organizatave dhe shoqatave; Ligji Nr 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse, Ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", Ligji nr. 8781, datë 2001.03. 05 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë". Ky kuadër lejon një proces të qartë për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve, në përputhje me standartet ndërkombëtare, por siç tregon praktika, kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri, megjithë ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vite, mbetet ende problematik dhe nevojitet të bëhen ndryshime për të lehtësuar ekzistencën dhe funksionimin e sektorit të OSHC-ve.

Sidomos legjislacioni fiskal paraqet barriera të ndryshme për OSHC-të. Regjimi aktual fiskal në organizatat jo-fitimprurëse cënon rolin e sektorit të shoqërisë civile dhe ka një ndikim negativ në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara nga sektori për grupet e synuara dhe përfituesit. Problematikë kryesore në këtë legjislacion mbetet trajtimi i barabartë i sektorit jo -fitimprurës dhe atij të biznesit, pavarësisht propozimeve nga OSHC-të për të bërë ndryshimet e duhura që çojnë në një trajtim të diferencuar të sektorëve, bazuar në karakteristikat e tyre. Ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor (gjatë vitit 2008, legjislacioni fiskal ndryshoi tre herë) e vështirëson punën e sektorit për ta ndjekur dhe t'u përshtatur, dhe rrit mundësitë për presion dhe trajtimin e padrejtë të OSHC-ve nga ana e autoriteteve shtetërore. Ky është rezultat i marrëdhënieve problematike ndërmjet sektorit të OSHC-ve dhe shtetit dhe për shkak të praktikimit të "dyerve të mbyllura", duke mos siguruar hapësira për konsultim me OSHC-të dhe grupet e interesit për nismat legjislative, apo

duke mos marrë parasysh propozimet e bëra nga sektori. Siç është cituar në Indeksën e USAID 2012 për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve për Shqipërinë "vendimmarrësit kanë injoruar në përgjithësi propozimet e OSHC-ve për të përmirësuar mjedisin ligjor për shoqërinë civile", duke çuar në një legjislacionin ekzistues që nuk pasqyron shqetësimet e sektorit, ka vështirësuar zbatimin e ligjeve nga OSHC-të, dhe ka ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të OSHC-ve.

Gjatë tre dekadave të fundit, prania dhe përfshirja e sektorit në çështjet publike ka qenë gjithnjë e më e dukshme. Presioni i saj në luftën kundër korrupsionit, në çështjet e ndjeshme që prekin jetën publike, në lobim për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në politikë dhe vendim-marrje, në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara, etj., është konsideruar si një hap pozitiv për të ndikuar në ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe inkurajimin e pjesëmarrjes qytetare për më shumë pjesëmarrje në vendimmarrje dhe proceset e hartimit të politikave në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes. Disa nga përvojat e suksesshme të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në konsultime dhe përgatitjen e ligjeve kombëtare dhe strategjive mund të përmenden: Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik Social (SKZHES) në vitin 2000, hartimi i Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, të miratuar në vitin 2007, projektligji "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri", miratuar nga Parlamenti në vitin 2008, miratimin e kuotës gjinore prej 30% në kodin zgjedhor për të rritur pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2007 -2013, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010, Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2005-2010, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2005-2010 dhe 2011-2015, etj. Përkundër këtyre arritjeve, vihet re ende mungesa e procedurave të standartizuara dhe mekanizmave që mundësojnë pjesëmarrjen efektive dhe në kohë të OSHC-ve në marrjen e vendimeve dhe krijimin e politikave, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

Marrëdhëniet midis shtetit dhe OSHC-ve janë karakterizuar nga një marrëdhënie sporadike dhe sipërfaqësore dhe shteti nuk e njeh plotësisht

rëndësinë e sektorit të OSHC-ve dhe zhvillimin e saj si një partner i pazëvendësueshëm në qeverisjen e mirë, avancimin e demokracisë, dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunimi dhe partneriteti mes shoqërisë civile dhe qeverisë është thelbësore dhe duhet të konsiderohet nga të dyja palët si një çështje prioritare për zhvillimin, jo vetëm si një kërkesë e Bashkimit Evropian që prezantohet në kuadër të procesit të integritit.

Në kushtet e krizës financiare dhe tërheqjes së donatorëve mungesa e një kuadri ligjor mundësues bëhet edhe më problematike, gjë që reflekton në uljen e OSHC-ve aktive në vend dhe diversitetit e aktiviteteve të tyre. Në këtë drejtim, mungesa e një strategjie kombëtare për zhvillimin e sektorit të OSHC-ve në Shqipëri, si dhe mungesa e koordinimit më të mirë midis OSHC-ve, shtetit dhe komunitetit të donatorëve çon në një sektor të brishtë në Shqipëri, jo të konsoliduar, dhe me një imazh të dobët në publik.

Sikundër edhe në vendet e tjera, një kuadër ligjor rregullator për një zhvillim të qëndrueshëm e aktiv të sektorit të OSHC-ve në Shqipëri është thelbësor. Duke marrë në konsideratë kriteret e ndryshme që do ta bënin këtë mjedis "mundësues" si: krijimi i një procesi regjistrimi të lehtë, transparent dhe me çmim të ulët, mbrojtja nga ndërhyrja e shtetit/ arbitrariteti në funksionimin e pavarur të OSHC-ve, krijimi i bazave ligjore e praktike të nevojshme për t'u përfshirë në aktivitete për gjenerimin e fondeve dhe përligjen e aktiviteteve fitimprurëse, rritja e mundësisë për marrjen e informacionit dhe dhe vendim-marrja; vendosja dhe zbatimi i rregullave të qarta të taksimit dhe prokurimit si edhe procedura që bëjnë diferencime mes sektorit jo-fitimprurës dhe sektorit privat, krijimi i mekanizmave shtetërore për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e OSHC-ve, etj., arrijmë në konkluzionin se ka ende shumë përpjekje për t'u bërë në Shqipëri për një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe praktik për OSHC-të, në përputhje me standartet e BE dhe ato ndërkombëtare.

Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri

Qysh në nisje të nismës, Partnerët Shqipëri

synoi të kishte një proces gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje të gjerë për të kryer raportin e monitorimit, duke prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të gjerë organizatash në të gjithë vendin. Një numër prej 150 përfaqësuesish të OSHC-ve morën pjesë në seminarët rajonale të organizuar në 8 qytete (Tiranë, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Fier, dhe Gjirokastër) për të prezantuar dhe diskutuar fushat, nën-fushat, dhe treguesit e Matricës. Gjithashtu, përmes kontakteve të emailit, Matrica u shpërnda në rreth 700 përfaqësues të OSHC-ve në të gjithë Shqipërinë.

Sfida kryesore me aplikimin e Matricës lidhet me risinë që ajo përfaqëson në diskutimin dhe matjen në tërësi të standardeve dhe fushave që mbulojnë mjedisin mundësues për OSHC-të. Kjo ishte një përvojë e re për stafin e partnerëve dhe për OSHC-të e përfshira në aplikimin e Matricës.

Një sfidë kryesore në kryerjen e vëzhgimeve që kanë të bëjnë me sektorin e OSHC-ve në Shqipëri, mbetet mungesa e informacionit zyrtar mbi sektorin e OSHC-ve (numrin, formën e regjistrimit, shpërndarjes gjeografike, tipologjia sipas fushave të aktiviteteve, etj.). Kjo situatë e bën procesin e përzgjedhjes së kampionit të vëzhgimit më sfidues dhe merr më shumë kohë.

Pyetësi i hartuar për vëzhgimin ishte i ndërlikuar duke përfshirë pyetje për të gjitha fushat dhe nën-fushat e Matricës për të matur mjedisin praktik të veprimtarisë së OSHC-ve. Si rezultat, trajnimi i stafit që do të përfshihej në kryerjen dhe administrimin e vëzhgimit ishte një çështje e rëndësishme që u trajtua në mënyrë të kujdesshme nga Partnerët Shqipëri. Intensiteti i punës në një afat kohor të limituar ishte një tjetër sfidë për stafin e përfshirë në administrimin e vëzhgimit.

Për hir të kompleksitetit të çështjeve që pyetësi mbulonte, ishte e nevojshme që ai të plotësohej nga drejtorët ekzekutivë të OSHC-ve, përmes një interviste ballë për ballë për të dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me të. Një tjetër sfidë ishte e lidhur me mungesën e informacionit mbi kuadrin ligjor të OSHC-ve nga drejtorët, gjë që çoi në përgjigje kontradiktore duke e bërë të vështirë analizën e informacionit të marrë. Për këtë arsye, pyetësi u pasua nga intervista të hollësishme për të shqyrtuar çështje të cilat binin

ndesh apo fusha ku ishte e nevojshme më shumë informacion për qëllime të analizës.

Disa nga nga veçoritë e Matricës ishin koncepte të reja për pjesëmarrësit e OSHC-ve. Kështu, dhurimi i kushtëzuar për shumë nga drejtorët ekzekutivë ishte një praktikë e panjohur dhe nuk ishte aplikuar gjatë veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, meqënëse stimujt për dhurime nuk ekzistojnë ose janë në masë shumë të ulët, OSHC-të nuk e shohin si mundësi bashkëpunimin me individë dhe kompani që zhvillojnë aktivitete filantropike apo aktivitete të PSK. Çështjet e lidhura me programet dhe strategjitë për vullnetarizmin ishin të vështira për t'u matur për shkak të mungesës dhe keqinformimit të OSHC-ve.

Një sfidë tjetër lidhet me vështirësitë për të siguruar informacion të saktë dhe të përditësuar nga autoritetet dhe institucionet publike, përmes kanaleve të tyre të informacionit që do të lehtësonte hulumtimin mbi kuadrin ligjor.

Mirënjohje dhe falenderime

Raporti i monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Organizatave të Shoqërisë Civile është përgatitur në bashkëpunim dhe me mbështetjen bujare të OSHC-ve, ekspertëve dhe individëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj drejtorëve ekzekutivë të përfshirë dhe ekspertëve të cilët morën pjesë në këtë raport monitorimi të parë duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e përkushtuar. Kontributi i tyre i dha një vlerë të paçmuar përmbajtjes së raportit.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen e saj Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës dhe Olof Palme International Center në Shqipëri për mbështetjen në zhvillimin, orientimin dhe zbatimin e kësaj përpjekje monitoruese.

Metodologjia

Përmbledhje e përjasjes metodologjike

Procesi i monitorimit u zhvillua gjatë vitit 2013. Ai nisi me përkthimin e Matricës në gjuhën shqipe për të lehtësuar prezantimin dhe për të arritur një kuptim më të mirë midis aktorëve të shoqërisë civile, si dhe prezantimit të tij si një paketë që do të përdoret nga OSHC-të për të advokuar lokalisht apo/dhe në nivel kombëtar. Partnerët Shqipëri përgatiti dhe përdori një set mjetesh metodologjike, duke përfshirë së bashku përjasjen me pjesëmarrje dhe panelin e ekspertëve në marrjen e të dhënave dhe informacionit me qëllimin e përgjithshëm monitorimit të standardeve në nivel legjislativ dhe praktik për identifikimin e progresit ose regresit të mjedisit mundësues duke përfshirë: klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe efektivitetin e implementimit të tij për veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri.

Përjasja metodologjike e ndjekur është si më poshtë:

1. Rishikim/Hulumtim literature

Duke marrë në konsideratë që Matrica përmban indikator rreth legjislacionit dhe praktikës, u krye hulumtimi i literaturës si më poshtë:

- 1.1. *Rishikim i kuadrit ligjor* – një hulumtim literature u krye për të vlerësuar kuadrin ligjor, rregulloret dhe nismat. Ajo përfshiu (i) një rishikim të legjislacionit Shqiptar (duke përfshirë vendimet rregulluese); analizat mbi ligjet, (rregulloret e kryera nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare)
- 1.2. *Rishikim i praktikës* – një hulumtim

literature u krye me qëllimin identifikimin e: (i) raporteve të OSHC-ve mbi nevojat për vlerësimin dhe implementimin e tyre (ii) raporteve të mediave që mbulojnë zbatimin praktik (iii) raporteve të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve dhe (iv) analizës së nevojave mbi fushat/çështjet dhe raportet ndërkombëtare apo dokumentet krahasuese mbi çështjen.

2. Vëzhgimi u realizua përmes administrimit të një pyetësi standart me 100 përfaqësues të OSHC-ve (vëzhgimi u krye me drejtorët ekzekutiv të tyre) në tetë qytete: Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Fier gjatë periudhës Maj – Korrik 2013. Vëzhgimi synoi të vlerësojë zbatimin praktik të kuadrit ligjor dhe rregullator për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri. Ai ishte hartuar bazuar në pyetje të mbyllura dhe të hapura për të vlerësuar standartet e Fushave 1, 2, dhe 3 dhe nën – fushat e Matricës. Partnerët Shqipëri zhvilloi intervista ballë për ballë për plotësimin e pyetësorëve, që ndihmuan në sqarime të hollësishme mbi çështje të ndërlikuara.

Pyetësi konsistoi në katër sesione, secili adresoi pyetje specifike në lidhje me fushat dhe nën – fushat e Matricës. Shkalla e vlerësimit për pyetjet ishin nga 1 – 5, ku 1 ishte shkalla më e ulët e vlerësimit dhe 5 shkalla më e lartë. Sesionet ishin si më poshtë:

- Të dhënat demografike – ky sesion mblodhi të dhëna demografike si: emri, gjinia, pozicioni, tipi i OSHC-së, fushat e aktiviteteve dhe adresa e tyre.
- Garancitë themelore juridike të lirive – ky sesion kishte për qëllim të pasqyroste

një panoramë të përgjithshme mbi nivelin praktik të garancive themelore juridike të lirive për OSHC-të në Shqipëri.

- Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të – Ky sesion synoi të vlerësonte praktikën mbi kuadrin ligjor fiskal në Shqipëri dhe mbështetjen e shtetit.
- Marrëdhënia Qeveri-OSHC – Ky sesion i fundit vlerësoi nivelin praktik të përfshirjes së OSHC-ve në politikë-bërje dhe vendim-marrje; në kontratat e prokurimit dhe shërbimet sociale.

3. Intervista të thelluara me drejtorë ekzekutivë të përzgjedhur të OSHC-ve, duke adresuar pyetje të lidhura me disa gjetje të studimit. Shtatë intervista u kryen për të marrë më tepër informacion dhe ndjekur çështje të identifikura, sidomos të kuadrin fiskal.

4. Paneli i ekspertëve i përbërë nga 9 ekspertë të njohur në të gjitha fushat e përfshira në Matricë vlerësuan se sa mbështetës dhe mundësues është mjedisi ligjor dhe rregullator në Shqipëri për OSHC-të.

Ekspertët përfaqësonin fushat si më poshtë:

- OSHC-të lokale me njohuri specifike dhe fokus të veçantë në një nga fushat dhe nën-fushat e Matricës;
- Ekspertë të njohur të shoqërisë civile, përfshirë edhe çështjet ligjore;
- Përfaqësues të universiteteve me ekspertizë në fushën e shoqërisë civile;
- OSHC partnere nga qeveria, biznesi dhe/ose media;
- Think tanks që punojnë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile.


Vlerësimi u krye përmes një pyetësori standart. Struktura e pyetësorit ishte e njëjtë me strukturën e pyetësorit të zhvilluar me OSHC-të, por që synoi të vlerësojë fushat/ nën –fushat dhe indikatorët e legjislacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet nga World Café⁴

Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve

Raporti i monitorimit u krye në tetë qytete me pjesëmarrjen aktive të 100 OSHC-ve.


Grafiku 1. Harta e shpërndarjes së kampionit



Grafiku 1 paraqet shpërndarjen gjeografike të organizatave që u përfshinë në vëzhgim.

4) Duke marrë në konsideratë që OSHC-të janë një partner i rëndësishëm i shtetit dhe një nga aktorët kryesor për zhvillimin e shoqërisë Shqiptare, në datat 13 dhe 16 dhjetor 2013, Partnerët Shqipëri organizoi Konferencën Kombëtare "Partnerë Social – Koha për Veprim". Në ditën e parë të konferencës, 130 përfaqësues nga OSHC u angazhuan në diskutimin sipas metodës World Café mbi tre çështje, në përputhje me fushat e Matricës. Gjetjet dhe rekomandimet e konferencës janë përdorur në përgatitjen e këtij raporti monitorimi dhe mund ti gjeni tek: http://www.partnersalbania.org/Rekomandimet_e_Sektorit_13_dhjetor.pdf


Grafiku 2. Forma e regjistrimit të organizatave brenda kampionit



Përsa i përket formës së regjistrimit, 59% e pjesëmarrësve në studim kanë deklaruar Shoqatë, 25% Qendër, 14% Fondacione, 1% Ndërmarrje Sociale dhe 1% Degë e një Organizate të huaj (Grafiku 2). Edhe pse ndërmarrjet

sociale nuk janë një formë regjistrimi e lejuar nga legjislacioni Shqiptar, Partnerët Shqipëri e përfshiu atë në studim si një alternativë duke marrë në konsideratë zhvillimet dhe prirjet e disa OSHC-ve drejt kësaj forme të re organizimi.

Grafiku 3. Fushat e aktivitetit të organizatave të kampionit



Bazuar në deklaratimet e tyre, më sipër paraqiten fushat e veprimtarisë së OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim dhe aktivitetet e tyre kryesore (Grafiku 3). Sikundër pasqyrohet në grafik ka një shpërndarje pothuajse të barabartë të kampionit midis OSHC-ve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e gruas, demokracisë, shërbimeve sociale, rinisë dhe shëndetësisë me një dominim të organizatave që punojnë në fushën e kulturës/edukimit dhe më pak përfaqësues të OSHC-ve që punojnë në fushën e biznesit.

Mësimet e nxjerra

- Përfaqësja e aplikuar gjithëpërfshirëse

dhe me pjesëmarrje siguroi një numër të gjerë pjesëmarrësish të OSHC-ve dhe pasqyroi zhvillimin e sektorit në të gjithë Shqipërinë (përpos hulumtimit dhe panelit të ekspertëve)

- Matrica prezantoi një set standartesh gjithëpërfshirëse dhe komplekse dhe ilustrimi me shembuj ishte shumë i vlefshëm në përgatitjen e raportit të monitorimit.
- Disa nga çështjet/fushat e Matricës kanë nevojë për rishikim të mëtejshëm për të reflektuar mjedisin ligjor dhe praktik të veprimtarisë së OSHC-ve në Shqipëri.

Gjetje dhe Rekomandime

Fusha 1: **Garancitë Themelore Juridike të Lirive**

Nën-fusha 1.1.: Liria e organizimit


Vlerësimi i kësaj nën-fushë bazohet në standartet e mëposhtme: (i) të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të themelojnë, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirisht në organizata jo-formale apo të regjistruara, offline dhe online; (ii) OSHC-të veprojnë lirisht, pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen e tyre të brendshme dhe në aktivitete; (iii) OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, burime financiare për të mbështetur aktivitetet e tyre.

Liria e organizimit është një e drejtë kushtetuese për çdo individ dhe person juridik pa asnjë diskriminim me bazë moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie apo etnie. Legjislacioni parësor si Kodi Civil⁵ dhe legjislacioni dytësor si Ligji mbi Organizatat Jo Fitimprurëse⁶ dhe ligji mbi Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse⁷, adreson dhe rregullon më tej këtë të drejtë. Regjistrimi për organizatat nuk është i detyrueshëm⁸, por praktika tregon se shumica e individëve dhe personave juridikë ushtrojnë aktivitetin e tyre të regjistruar si shoqatë, qendër apo fondacion (tre format e regjistrimeve që njihen nga Ligji mbi Organizatat Jo Fitimprurëse).

Regjistrimi bëhet bazuar në një aplikim nga subjektet e interesuara, i cili dorëzohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, institucioni i vetëm publik përgjegjës për regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri. Paketa e dokumentacionit, bashkëngjitur në aplikim, përfshin: statutin dhe aktin e themelimit, të miratuar nga themeluesit e organizatës jo-fitimprurëse dhe të certifikuar nga një noter. Themeluesit autorizojnë një ose më shumë persona të kryejnë aktin e regjistrimit dhe të ndjekin të gjithë procesin e regjistrimit⁹. Vendimi i regjistrimit merret nga një gjykatës i sektorit tregtar të gjykatës. Gjykatësi vendos mbi aplikimin e regjistrimit brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës në gjykatë¹⁰. Por në praktikë, siç u evidentua nga diskutimet e panelit të ekspertëve, ka raste kur procesi i regjistrimit vonohet. Në rastet e refuzimit të aplikimit nga gjykatësi, aplikuesi mund të apelojë vendimin në Gjykatën e Apelit në Tiranë¹¹. Kostot e regjistrimit janë të lidhura me përgatitjen dhe certifikimin e dokumenteve nga noteri, pagesën e avokatit për t'i shqyrtuar ato dhe për të ndjekur procesin në gjykatë dhe taksa të tjera të lidhura me procedurat e regjistrimit në gjykatë. Siç vlerësohet edhe në raportin monitorues, për organizatat me qendër jashtë Tiranës, ka kosto shtesë, si pasojë e centralizimit të procesit të regjistrimit vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë, gjë që përbën një pengesë për OSHC-të. Siç përmendet edhe në Indeksën e Qëndrueshmërisë së OSHC-ve

- 5) Ligji nr.8781, datë 03.05.2011, Për Disa Amendime të Ligjit 7850, datë 07.29.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"
- 6) Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 mbi "Organizatave Jo-Fitimprurëse"
- 7) Ligji nr.8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"
- 8) Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 mbi "Organizatave Jo-Fitimprurëse", Neni 3,
- 9) Ibid, Neni 13
- 10) Ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", Neni 24
- 11) Ibid", Neni 25

Grafiku 4. Vlerësimi i procesit të themelimit të OSHC-ve



në 2012 nga USAID “vendimarrësit kanë vazhduar të injorojnë kërkesat e shoqërisë civile për të decentralizuar procedurat e regjistrimit.”

Në përgjithësi, kuadri ligjor i regjistrimit konsiderohet i përshtatshëm dhe lejon një proces regjistrimi të hapur dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare, siç është vlerësuar nga paneli i ekspertëve dhe 65% e OSHC-ve (Grafiku 4).


Përveç faktit se liria e individëve për të qenë pjesë e OSHC-ve garantohet me ligj, kjo liri respektohet gjithashtu edhe në praktikë. Të pyetur se si e vlerësojnë pjesëmarrjen e individëve në organizatat jo-fitimprurëse, 69% e OSHC-ve

deklarojnë se pjesëmarrja është e lehtë (56%) dhe shumë e lehtë (13%). Në disa raste, pjesëmarrja pengohet nga mundësitë e kufizuara të aksesit për shkak të distancës së zonës së banimit nga vendndodhja e OSHC-së, sidomos për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.

Kuadri ligjor garanton¹² dhe praktika tregon se OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrjen e shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme.

86% e OSHC-ve të anketuara, shprehen se nuk ka (67%) ose është e moderuar (19%) ndërhyrja e shtetit në qeverisjen e brendshme të tyre (Grafiku 5), ndërkohë që 67% e OSHC-ve shprehen se nuk

Grafiku 5. Vlerësimi i ndërhyrjes së shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC-ve



12) Ibid, Neni 7

ka (52%) ose ka pak (15%) ngacmim dhe kontroll të tepruar nga ana e shtetit, ndërkohë që 59% e tyre shprehen se sanksionet aplikohen rrallë ose aspak. Këto rezultate lidhen me faktin që një numër i konsiderueshëm OSHC që morën pjesë në këtë raport janë organizata të vogla me burime të limituara dhe kapacitete të pamjaftueshme për të advokuar për çështje publike, dhe pjesërisht sepse sektori është i dobët, veçanërisht kur duhet të luajë rolin monitorues watchdog, për të cilën rastet janë të pranishme vetëm në qytetet e mëdha si Tirana. Megjithatë ka raste ku qeveritë kanë ushtruar presion politik mbi OSHC-të duke shkelur ligjin e 2010 mbi inspektimin financiar, manaxhimin financiar dhe kontrollin. Në vitin 2011 autoritetet tatimore gjobitën Mjaft! mbi baza të paqarta. Mjaft! dorëzoi 2 çështje në gjykatë kundër gjobës dhe raportit të përgatitur nga autoritetet tatimore. Në dhjetor të 2012, Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë vendosi në favor të organizatës Mjaft!¹³

Raportimi financiar i OSHC-ve rregullohet me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2001 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Ligji për Inspektimin Financiar nr. 10294, datë 01.07.2010 i cili hyri në fuqi në Korrik të 2010. Në ligjin mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare nuk ka specifikime dhe forma të diferencuara mbi pasqyrat financiare dhe raportimin e OSHC-ve. Ato trajtohen dhe kanë të njëjtin detyrim raportimi dhe kontabiliteti me sektorin e biznesit. Në të njëjtën kohë, ligji aplikon të njëjtat rregulla raportimi financiar për të gjitha OSHC-të duke mos ndjekur principin e proporcionalitetit në lidhje me madhësinë e organizatës dhe qëllimin/llojin e aktivitetit¹⁴. Gjatë viteve të fundit, organizatat në Shqipëri janë të detyruara të paraqesin raportin vjetor tek autoritetet tatimore. Gjithashtu, organizatat duhet të paraqesin raportet e TVSH online, pavarsisht faktit që nuk janë të angazhuara në aktivitet ekonomik. Ky sistem konsiderohet jo efektiv dhe jo i duhur dhe ekziston një nevojë për të përmirësuar raportimin financiar aktual të taksave-ligjin përkatës përmes një

kuadri rregullues të veçantë për sektorin e tretë. Nga ana tjetër OSHC-të në vetvete duhet të rrisin transparencën e tyre të brendshme, llogaridhënien dhe vendimmarrjen demokratike¹⁵

Transformimi, bashkimi, ndërprerja e veprimtarisë dhe shpërndarja parashikohen në kapitullin VIII të Ligjit për organizatat jofitimprurëse, në përputhje me standartet ndërkombëtare, si dhe në ligjin për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse¹⁶.

Burimet e të ardhurave për organizatat jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizimi kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse¹⁷. Në çdo rast, legjislacioni nuk paraqet asnjë pengesë në lidhje me mundësinë për të marrë fonde, qofshin këto lokale apo të huaja. 65% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan që ato lirisht mund të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga donatorë të huaj, ndërsa ndeshin vështirësi për të aksesuar fondet në dispozicion nga ana e shtetit (67% nuk kanë marrë asnjë fond nga qeveria qendrore, 69% nuk kanë marrë asnjë fond nga qeverisja lokale, 75% e tyre nuk kanë marrë asnjë fond nga prokurimi publik). Vështirësitë e OSHC-ve për gjenerimin e fondeve janë më së shumti të lidhura me fonde të limituara nga autoritetet lokale, mungesa e kapaciteteve të organizatave të vogla për të konkurruar me standarte të kërkuara për të aksesuar fonde të huaja, dhe mungesa e besimit në transparencën dhe shpërndarjen e drejtë të fondeve nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Këto të dhëna konfirmojnë edhe një herë faktin që sektori i OSHC-ve është i varur nga donatorët. Gjithashtu, tarifat bankare që nuk quhen si shpenzime të lejuara nga disa donatorë, duke përfshirë këtu edhe BE-në rrisin koston organizative duke paraqitur një barrë për OSHC-të.

Sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse. OSHC-të "kanë të drejtë të ushrojnë çfarëdo lloji veprimtarie të ligjshme"¹⁸ dhe "përfitimet duhet

13) USAID, Indeksi për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve 2011/ Indeksi për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve 2012

14) http://www.partnersalbania.org/Rekomandimet_e_Sektorit_13_dhjetor.pdf

15) Raport Kombëtar: Shqipëria, profili i vendit për 2012, përgatitur nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konfliktit, për konferencën rajonale të shoqërisë civile "FOR EUROPE OF THE EASTERN BALKANS", 26-28 shtator 2012 – Zadar, Kroaci

16) Kapitulli VII

17) Ligji Nr.8788, datë 07.05.2001 mbi "Organizatat Jo-Fitimprurëse", neni 35

18) Ibid, neni 34

të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të specifikuar në statut dhe aktin e themelimit”¹⁹ Bazuar në sa më sipër, OSHC- të mund të kenë përfitime, por sipas Kodit Civil, neni 39/1 citon se “nuk lejohen që shoqatat të kryejnë veprimtari fitimprurëse”, neni 56/1 “nuk lejohen që fondacionet të kryejnë veprimtari fitimprurëse” dhe neni 11 i ligjit për organizatat jofitimprurëse citon “nuk lejohen që qendrat të kryejnë veprimtari fitimprurëse”. Gjithashtu neni 35 përsëkrjuan se “Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e organizatës jofitimprurëse prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës jofitimprurëse”. Kjo çon në interpretimin që nxjerrja e përfitimeve nuk i referohet angazhimit në aktivitete që mund të jenë fitimprurëse, por ndarjes së përfitimeve²⁰. Për shkak të këtij konfuzioni ligjor, OSHC-të hasin barriera dhe pengesa gjatë zhvillimit të një aktiviteti ekonomik²¹, që çon në faktin që 58% e OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim nuk sigurojnë fonde nga shërbimet me pagesë.

Kuadri ligjor ekzistues nuk favorizon aktivitetin ekonomik²² të ushtruar nga OSHC-të. OSHC-të përdorin vetëm një format raportimi për aktivitetet ekonomike dhe për aktivitetet jo-ekonomike, që gjithashtu konfirmon konfuzionin e përgjithshëm se çfarë janë aktivitetet ekonomike dhe aktivitetet jo-fitimprurëse²³. Diferencimi ndërmjet aktivitetit ekonomik dhe atij jo ekonomik është shumë i rëndësishëm, sepse veçanërisht ai është i lidhur me diferencimin në trajtimin fiskal të këtyre dy

aktiviteteve²⁴.

Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera

Vlerësimi i kësaj nën-fushe është bazuar në standartet e mëposhtme: (i) Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore; (ii) Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht apo përmes organizatave, gëzojnë lirinë e shprehjes; (iii) Përfaqësuesit e shoqërisë civile, individualisht dhe përmes organizatave të tyre, kanë të drejtën për të marrë dhe ndarë informacion të sigurtë përmes çdo media.

Kuadri ligjor Shqiptar garanton të drejtën e lirisë së organizimeve paqësore. Kjo e drejtë garantohet përmes Kushtetutës së Shqipërisë²⁵ dhe është e specifikuar në ligjin e Tubimeve²⁶. Sipas ligjit të tubimeve “çdo qytetar ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe jo të armatosura dhe mbledhja bëhet pa asnjë diskriminim nën mbrojtjen e policisë së shtetit”. Kjo e drejtë kufizohet vetëm në rastet kur tubimet kompromentojnë sigurinë kombëtare, ruajtjen e rendit publik dhe parandalimin e krimit, ruajtjen e shëndetit dhe moralit, apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave të tjerë. Ligji rregullon procedurat e njoftimit paraprak në rastet kur mbledhja/tubimi zhvillohet në hapësira publike apo në vendkalime publike, dhe kërkesën për mbështetjen nga policia e shtetit për të shmangur trazirat gjatë apo pas zhvillimit të mbledhjeve/tubimeve. Sipas nenit 12 të këtij ligji, mbledhjet në hapësirat e hapura publike mund të zhvillohen edhe pa një njoftim paraprak të policisë. Neni 25 parashikon të drejtën e apelimit ndaj vendimit të dhënë nga shefi i komisariatit ose oficeri i policisë përgjegjës për zhvillimin e mbledhjes / tubimit.

19) Ibid, neni 35

20) Vlerësimi mbi Kuadrin Ligjor Fiskal të Shoqërisë Civile në Shqipëri, Soros & ECNL 2011

21) http://www.partnersalbania.org/Rekomandimet_e_Sektorit_13_dhjetor.pdf


22) Ibid

23) Raport Vlerësimi mbi Kuadrin Ligjor Fiskal të Shoqërisë Civile në Shqipëri, Soros & ECNL 2011

24) Kjo është një nga kërkesat e prezantuar nga OSHC-të në Konferencën Kombëtare “Partnerë Social – Koha për Veprim” si pjesë e deklaratës së organizatave të shoqërisë civile për t’u adresuar nga qeveria brenda vitit 2014.

25) Neni 46,47

26) Ligji Nr. 8773, datë 23.4.2001



E drejta e lirisë për organizime paqësore është një e drejtë që respektohet edhe në praktikë, siç është vlerësuar nga 74% e OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim (Grafiku 6). Mbledhjet/tubimet janë organizuar në konform dhe duke respektuar ligjin dhe roli i policisë ka qenë mbështetës. 77% e OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim theksuan se nuk ka patur raste të ndërhyrjes së shtetit gjatë tubimit/mbledhjes. Prania e medias në tubimet dhe mbledhjet paqësore është vlerësuar pozitivisht nga 77% e OSHC-ve, të cilat kanë patur vëmendje të lartë të medias (42%) apo të mjaftueshme (34%) gjatë tubimeve të tyre.

Liria e shprehjes është një liri themelore. Shqipëria ofron garanci kushtetuese dhe ligjore për të drejtën e qytetarëve për tu shprehur lirisht, siç është vlerësuar edhe nga paneli i ekspertëve. Çdo kufizim, siç është kufizimi i gjuhës së urrejtjes, të imponuar nga ligji përshkruhen qartë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, Sesioni VIII: Veprat penale për shpifje kundër moralit dhe dinjitetit. Në vitin 2012, Ministria e Drejtësisë porpozoi ndryshime lidhur me dekriminalizimin e shpifjes duke u bërë subjekt i Kodit Civil në vend të Kodit Penal. Por këto ndryshime nuk u aprovuan nga Komisioni i Ligjeve në Parlament. I vetmi ndryshim i pranuar ishte madhësia e ndëshkimit për shpifje nga burgim në gjobë.

Nga vëzhgimi nuk u raportua asnjë rast i dhunimit të së drejtës së shprehjes, persekutimit të individëve apo përfaqësuesve të OSHC-ve mbi fjalimet kritike në publik apo privat apo sanksioneve për fjalimet kritike në publik apo privat. OSHC-të në Shqipëri gëzojnë dhe ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes pa ndonjë ndërhyrje. Ato lirisht mund të organizojnë seminare, konferenca dhe evente të tjera publike për të diskutuar çështje të ndryshme, për të marrë pjesë dhe shprehur pikpamjet e tyre në mediane dhe shkruar, elektronike dhe atë sociale, duke përfshirë edhe pikpamjet kritike ndaj qeverisë. 58% e OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim u shprehën se ka një liri të lartë të shprehjes nga OSHC-të. Megjithatë ka raste të rralla siç është rasti i katër aktivistëve nga Lëvizja Rinia Aktive, të cilët u arrestuan në Tiranë dhe u akuzuan për “shpifje dhe shpërndarjen e informacioneve të rreme”, pas postimit të një nekrologjie tallëse të kryeministrit të Shqipërisë. Ata u liruan dy ditë pas vendimit të prokurorisë për të mos ngritur akuzat kundër tyre nga policia.

Ligji kryesor që rregullon aksesin dhe komunikimin përmes çdo media dhe TIK është ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Mbi Komunikimin Elektronik në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tij normative²⁷. Përpos këtyre, janë hartuar dhe aprovuar një seri strategjish dhe

27) VKM, nr. 1252, datë 10.09.2008 për “Miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”;
I ndryshuar me: VKM nr.501, datë 9.6.2010; VKM, nr.465, datë 6.5.2009 për “Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2009, për autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare”;
VKM nr.479, datë 6.5.2009 për “ Miratimin e planit kombëtar të frekuencave”

dokumente kombëtare si: Strategjia Kombëtare e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (krijuar 2005/2006), Miratimi i Dokumentit të Politikave të Komunikimit Elektronik të Republikës së Shqipërisë në shkurt 2010, Strategjia Ndërsektoriale 2008-2013, Nisma e Shqipërisë Dixhitale, Programi TIK 2007-2008, Strategjia Kombëtare ICT4D, Strategjia Ndërsektoriale për Informimin e Shoqërisë²⁸.

Siç citohet edhe tek Raporti i TIK profili i vendit Shqipëri, 2011 i USAID, shumica e kërkesave bazike lidhur me kuadrin ligjor në mënyrë që të lehtësojë dhe mbështesë implementimin dhe përmirësimin e teknologjive, shërbimeve dhe rregulloreve të reja të sektorit të TIK-ut në Shqipëri janë përmbushur. Siç përmendet në këtë raport disa çështje të cilat mbeten për t'u adresuar janë penetrimi i ulët i linjave fikse dhe internetit, përqindje e ulët e personave që disponojnë kompjuter personal, çmimi i lartë i internetit dhe shërbimeve, nivel i ulët ndërgjegjësimi i përfitimeve nga përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit, hendeku dixhital midis zonave urbane dhe rurale në krahasim me vendet e tjera të Evropës, niveli i ulët i mbështetjes së subvencionit nga shteti si dhe mungesa e politikave për sa më sipër. Këto çështje afektojnë dhe ekzistencën dhe veprimtarinë efektive të OSHC-ve, sidomos atyre në zonat rurale dhe të largëta ku probleme të tilla janë më të dukshme, duke bërë penetrimin e internetit të mos jetë gjerësisht i arritshëm dhe i përballeshëm nga OSHC-të. Në lidhje me aksesin ndaj internetit 80% OSHC-ve që morrën pjesë në vëzhgim kanë adresa emaili, ndërsa vetëm 50% kanë faqe të tyre në internet. Bashkëpunimi me median është vlerësuar i lehtë nga 42 % e OSHC-

ve, ndërsa 27% kanë vlerësuar se është disi i vështirë. Në Shqipëri ka shumë rrjete sociale të OSHC-ve, të cilat komunikojnë dhe shkëmbejnë informacion me njëra-tjetrën pa raportuar asnjë ndërhyrje. Rrjete të tilla mund të përmendin: Albania Act Now!; Aleanca Kundër Importit të Plehrave, Mbron Fëmijët, Aleanca Prindërore për mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi), etj.

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të


Nën-fusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre

Vlerësimi i kësaj nën-fushe është bazuar në standartet e mëposhtme: (i) Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve; (ii) Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata.

Në Shqipëri, burimet e të ardhurave për organizatat jo-fitimprurëse janë të ardhurat nga **kuotizacioni** kur ka të tilla, **grante** dhe **donacionet** e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga **veprimtaria ekonomike** dhe **pasuritë** në pronësi të organizatës jo-fitimprurëse²⁹. Në të njëjtën kohë neni 40 i ligjit për Organizatat Jo-fitimprurëse citon "pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë." Edhe pse të ardhurat nga grantet përbëjnë pjesën më të madhe të burimeve të të ardhurave për OSHC-të në Shqipëri, në ligjin për Organizatat Jo-fitimprurëse, duket që **grantet** nuk përfshihen në përjashtimin mbi të ardhurat.

28) USAID, ICT Country Profile Albania, 2011, Regional Competitiveness Initiative

29) Ligji Nr.8788, datë 07.05.2001 mbi "Organizatat Jo-Fitimprurëse"



Ky përjashtim mund të çojë në interpretime jo të sakta nga autoritete të ndryshme shtetërore, donator dhe OSHC-sh në Shqipëri siç tregohet edhe nga rezultatet e vëzhgimit të OSHC-ve 24% e OSHC-ve deklaruan se taksë mbi grantet aplikohet “shumë”, 16% deklaruan që taksë mbi grantet aplikohet “mjaftueshëm”, 9% “disi”, 9% “pak”, dhe vetëm 42% e OSHC-ve deklaruan që “nuk aplikohet” taksë mbi grantet. (grafiku 7).

Por nga intervistat e thelluara me përfaqësues të OSHC-ve të cilët deklaruan që aplikohet taksë mbi grante, u sqarua që nuk ishte taksë mbi grante e aplikuar dhe paguar tek autoritetet shtetërore, por ishte kërkesë e donatorëve për OSHC-të që të raportojnë fatura me TVSH për grantin e marë. Si përfundim mund të themi se ka një konfuzion si në nivel legjislativ ashtu edhe atë praktik përsa i përket përjashtimit të granteve nga skema e tatimit. Duke marrë në konsideratë sa më sipër, është shumë e rëndësishme që të sqarohet në ligj përjashtimi i grantit ndaj çdo lloji tatimi. Kjo do t'i japë fund mundësisë për interpretime të ndryshme nëse grantet janë pjesë e aktivitetit joekonomik të OSHC-ve apo jo³⁰.

Ndërsa aktiviteti ekonomik nuk është subjekt i taksës mbi të ardhurat, aktiviteti ekonomik është subjekt i tatimit prej 10% të fitimit (të njëjtë me kompanitë që taksohen me të njëjten masë për fitimin). Në praktikë,

sikundër është e vështirë të diferencohet aktiviteti ekonomik dhe ai jo-ekonomik, shumica e OSHC-ve nuk janë të ndërgjegjshme se çfarë taksash duhet të paguajnë për të ardhurat e tyre³¹.

OSHC-të duhet të raportojnë nën regjimin e sistemit të TVSH edhe pse formalisht nuk kanë qarkullimin e nevojshëm nga aktiviteti ekonomik. Pragu i qarkullimit për të raportuar TVSH është 2 milion lekë dhe në këto kushte është totalisht e pajustificueshme se pse OSHC-të, duke përfshirë këtu dhe ato që nuk kryejnë aktivitet ekonomik, duhet të raportojnë TVSH³². Por përveç kësaj, ligji i TVSH përfshin një dispozitë sipas së cilës furnizimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse me çmim të ulët janë të përjashtuara nga TVSH në qoftë se ato janë Organizata me Përfitim Publik, statusi i të cilëve jepet nga Ministria e Financave. Sipas dokumentit³³, statusi i përfitimit publik i jepet organizatave që, si veprimtari kryesor, zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik. Këto organizata duhet të ofrojnë shërbimet e tyre me një çmim më të ulët me 50% nga çmimi i tregut, dhe të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve nuk mund të mbulojnë më shumë se 50% të kostos për sigurimin e tyre, në mënyrë që të marrin statusin e përfitimit publik. Ka tre çështje kryesore që kanë të bëjnë me këtë vendim: 1) ajo duhet të adresohet në nivel ligji dhe jo nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, që

30) Kjo është një nga kërkesat e prezantuara nga OSHC-të në Konferencën Kombëtare “Partnerë Social – Koha për Veprim” si pjesë e deklaratës së organizatave të shoqërisë civile për t’u adresuar nga qeveria brenda vitit 2014.

31) Raport Vlerësimi mbi Kuadrin Ligjor Fiskal të Shoqërisë Civile në Shqipëri, Soros & ECNL 2011

32) Ibid

33) VKM nr. 1679 date 24.12.2008 “Kriteret dhe procedura e percaktimit të statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik”

i bën kriteret subjekt të ndryshimeve të shpeshta, 2) fushat e aktiviteteve të adresuara në vendim nuk pasqyrojnë realitetin në terren në lidhje me fushat e aktivitetit të OSHC-ve; 3) rregullat dhe procedurat në mbështetje të këtij vendimi janë të paqarta.

Në praktikë, 67% e OSHC-ve të anketuara deklarojnë se nuk ka përfitime tatimore për aktivitetin ekonomik të OSHC-ve, duke i bërë ato jo efektive dhe jo mbështetëse për OSHC-të. Disa nga lehtësirat fiskale të rekomanduara nga OSHC-të, për të mundësuar dhe mbështetur veprimtarinë e tyre ekonomike, do të ishin: trajtimi i ndryshëm mes OSHC-ve dhe bizneseve; përjashtimi nga skema e TVSH-së apo uljen e vlerës së TVSH-së për OSHC-të, rimbursimin e TVSH; lehtësira / stimulime për ndërmarrjet sociale, përjashtimi nga çdo taksë për aktivitetet ekonomike³⁴.

OSHC-të nuk janë të përjashtuara të angazhohen në investimet pasive, nenet 39/1 dhe 56/1 të Kodi Civil shprehin që shoqatat dhe fondacionet lejohen të zotërojnë asetet e luajtshme dhe të paluajtshme për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, neni 35 i ligjit për Organizatat Jofitimprurëse, njih të ardhurat nga asetet në pronësi të organizatës jofitimprurëse, si një burim i të ardhurave. Aktualisht, investimet pasive trajtohen në të njëjtën mënyrë si aktivitetet e biznesit, dhe taten respektivisht, pa përjashtime sipas legjislacionit tatimor. Por, me një ndryshim të Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse, OSHC-të përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat e realizuara përmes interesit bankar.

Nuk ka ligj mbi dhurimet e kushtëzuara dhe koncepti është ende i panjohur për OSHC-të. Kjo pengon qëndrueshmërinë e sektorit dhe kufizon burimin e të ardhurave.

Ligji për Organizatat Jofitimprurëse parashikon masën për uljen e taksave për individët dhe korporatat që dhurojnë tek OSHC-të³⁵, ndërsa Ligji nr.7892, dt. 21.12.1994 mbi Sponsorizimin konsideron si sponsorë “vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj ose të ndërmarrjeve të përbashkëta”. Ky përkufizim në ligj, mundëson përfitime vetëm për kompanitë e biznesit dhe individëve që kanë “cilësinë e

tregtarëve”, duke përjashtuar punonjësit që marrin paga, përfshirë gjithë administratën publike.

Nga ana tjetër ligji mbi Sponsorizimet njih si aktivitete të lejuara për të përfituar ulje të taksave vetëm aktivitetet sociale dhe publike duke përfshirë aktivitetet humanitare, artistike dhe kulturore, sport, edukim, aktivitete ekologjike, literature, si dhe aktivitete enciklopedike dhe shkencore. Lista e aktiviteteve mund të konsiderohet e limituar, pasi nuk reflekton të gjitha fushat e lidhura me të drejtat e njeriut dhe demokracisë, ku një numër i lartë organizatash janë të angazhuara (41% e OSHC-ve të anketuara në kuadër të këtij raporti monitorimi punojnë në fushën e demokracisë).

Niveli i uljes së taksave nuk është mifatueshëm inkurajues për dhurimet e individëve dhe kompanive ndaj OSHC-ve. Në një raport vëzhgimi përgatitur nga Partnerët Shqipëri në vitin 2011 mbi Sipërmarrjen dhe Filantropinë, kompanitë që kryenin aktivitete filantropike listuan të parin element krijimin e incentivave që do të mundësonin uljen e taksave për kompanitë që kryejnë aktivitete filantropike, si një nga arsyt kryesore që do të motivonte kryerjen e aktivitetit filantropik. Në të njëjtën kohë, kompanitë të cilat nuk kryenin aktivitete filantropike identifikuan procedurat e vështira të rimbursimit si një nga arsyt kryesore për të mos u angazhuar në aktivitet filantropik. Kjo situatë reflektohet edhe në gjetjet e Matricës së monitorimit ku 53% e OSHC-ve të anketuara nuk kanë marrë asnjë dhurim nga individët dhe kompanitë për aktivitetet e tyre dhe vetëm 7% deklaruan që kanë “shumë dhurime”.

Këto fakte çojnë në nevojën për rishikim të ligjit të Sponsorizimeve për më tepër lehtësira/incentiva fiskale për dhurimet, si dhe thjeshtëzimit të procedurave të rimbursimit. Përpos këtyre, kushte të tjera që do të rrisnin dhurimet siç edhe janë vlerësuar nga OSHC-të janë:

- Njohja e dhurimit (bërja e dukshme dhe publike)
- Rritja e transparencës dhe kredibilitetit të OSHC-ve drejt publikut
- Advokaci

34) Ligji nr. 92/2013 Për disa Shtesa dhe Ndryshime në ligjin nr.8788, date 7.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, miratuar në 28.2.2013

35) Neni 40 i Ligjit

- Bashkëpunimi me qeverinë lokale
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit publik
- Zhvillimi i Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatave

Zhvillimi i Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatave është një fushë e re zhvillimi në Shqipëri. Arritjet më të spikatura për tu përmendur janë: krijimi i një Rrjeti lokal të Kombeve të Bashkuara Global Compact, zhvillimin e Dokumentit të Politikave për PSK, miratimin e Kodit të Qeverisjes së Korporatave për kompanitë e palistuara, hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për PSK dhe treguesit përkatës, krijimi i Forumit multi-aktorial të PSK, adaptimi i standarteve ISO 260000, trajnimi i gazetarëve nga mediat lokale dhe çmimi për projektet në fushën e PSK³⁶.

Konferenca rajonale “Zhvillimi i Përgjegjshmërisë Sociale të Biznesit - Sfida dhe Praktika në Rajon”, organizuar nga Partnerët Shqipëri më 5 qershor 2012, mbledhi së bashku në një debat publik, përfaqësues të sektorit të biznesit, institucioneve qeveritare, organizatave jofitimprurëse dhe medias nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia, për të adresuar çështje të rëndësishme mbi perspektivat e zhvillimit të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatave, sfidat dhe praktikat më të mira nga rajoni, rolin katalizues të qeverisë dhe medias, si aktorë të rëndësishëm në edukimin dhe promovimin e praktikave në publik të përgjegjshmërisë sociale të korporatave. Megjithatë, mbetet nevoja për politika publike kombëtare mbi zhvillimin e PSK duke marrë në konsideratë nevojat e OSHC-ve dhe përfshirjen e tyre në programet e tyre.

Nën-fusha 2.2.: Mbështetja e shtetit

Vlerësimi i kësaj nën-fushe bazohet në standartet e mëposhtme: (i) Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE dhe granteve të tjera, (ii) Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente, (iii) Ka një sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike, (iv) Ekziston

mbështetja jo-financiare nga shteti.

Shqipëria nuk ka një strategji (dokument) kombëtare që rregullon mbështetjen e shtetit për zhvillimin institucional të OSHC-ve dhe që targeton shoqërinë civile si të tërë. Por, në vitet e fundit, qeveria Shqiptare dhe organizatat e shoqërisë civile kanë ndërmarrë hapa pozitive drejt promovimit dhe ngritjes së mekanizmave për të siguruar mbështetje për OSHC-të.

Një zhvillim i rëndësishëm i mbështetjes së shtetit për OSHC-të përmes fondeve publike është krijimi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)³⁷ në vitin 2009. Agjencia është një entitet ligjor publik që manaxhohet nga një Bord Mbikëqyrës i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtarë të qeverisë. Bazuar në ligj, përfaqësuesit e shoqërisë civile përcaktohen në bazë të kontributit dhe eksperiencës së tyre sipas përfaqësimit proporcional të fushave kryesore dhe të zhvillimit dhe prioritetet strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile. Të gjitha OSHC-të e regjistruara kanë të drejtë të dërgojnë propozimet e tyre për përfaqësim në Bordin Mbikëqyrës. Sipas raportit të Freedom House 2013³⁸, përfaqësuesit e OSHC-ve në bordin mbikëqyrës të AMSHC janë “aktivistë të shoqërisë civile pro qeverisë, e cila ndikon në paanësinë e agjencisë. Organizatat monitoruese dhe lëvizjet që kryejnë fushata kundër politikave të qeverisë nuk kanë gjasa të marrin mbështetje nga Agjencia”. I njëjti vlerësim vjen nga përfaqësuesit e OSHC-ve.

Agjencia filloi veprimtarinë në 2010. Gjatë këtyre tre viteve AMSHC ka publikuar katër thirrje për projekte në total duke ftuar OSHC-të të aplikonin. Thirrja e parë është publikuar në 2010 me një buxhet total prej 125,918,000 Lekë³⁹. Gjatë këtij viti vetëm 52 organizata kanë marrë mbështetje financiare me një shumë totale prej 62,959,000 Lekë si pjesë e disbursimit të parë të grantit. Gjatë 2011 Agjencia ka publikuar 2 thirrje për projekte për OSHC-të⁴⁰. Thirrja e parë u publikua në mars 2011, fokusuar vetëm në projekte rreth promovimit të turizmit dhe kulturës në kuadrin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore (ka qenë një nga prioritetet e qeverisë gjatë 2011). Nga 69

36) Analiza e Situatës mbi Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatave në Shqipëri, Praktika dhe sfida aktuale të Industrisë Nxjerrëse, prezenca e OSBE në Shqipëri & Amabsada Kanadeze në Shqipëri, Mars 2013.

37) Ligji Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile”

38) http://www.freedomhouse.org/report/nations-transit/2012/albania#.Utac_13aQëo


39) http://www.amshc.gov.al/web/raporte/vjetore/2010/Raporti_Vjetor_2010_shqip.pdf

40) http://www.amshc.gov.al/web/raporte/vjetore/2011/Raporti_Vjetor_2011_shqip.pdf

aplikime vetëm 31 OSHC rezultuan fituese me një buxhet total prej 16,000,000 Lekë. Thirrja e dytë u publikua në nëntor 2011 dhe vetëm në janar 2012 Agjencia disbursoi 131,960,000 Lekë për OSHC-të fituese. Thirrja e katërt dhe e fundit u

publikua në dhjetor të 2012 dhe vetëm në Prill të 2013 Agjencia publikoi në faqen e saj 61 fituesit me një fond prej 56,675,000 Lekë⁴¹. Nga këto të dhëna mund të vëzhgohet se buxheti i shtetit nga viti në vit është pothuajse i njëjtë.

Grafiku 8. Fondet publike u përgjigjen nevojave të OSHC-ve



Procedurat e dhënies së granteve të Agjencisë lejojnë grante shumë vjeçare dhe kjo konsiderohet si një praktikë e mirë. Sikundër është përmendur edhe në raportet vjetore të AMSHC, fushat e prioriteteve vendosen në konform me prioritetet e qeverisë Shqiptare dhe nuk janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, apo bazuar në konsultime me sektorin e OSHC-ve. Përveç kësaj, Agjencia financon aktivitete që paraqesin një konflikt të qartë interesi. Kjo mbështetet edhe nga rezultatet e vëzhgimit me OSHC-të, në të cilën 68% shprehin se mbështetja e shtetit nuk i përgjigjet aspak nevojave të tyre (Grafiku 8).

Përpos granteve të alokuara për projekte në fusha specifike zhvillimi, sipas Rregullores së Procedurave të financimit mbi grantet, Agjencia duhet të ofrojë lloje të ndryshme mbështetje me grante. Një nga format e mbështetjes është financimi i mbështetjes institucionale si një investim strategjik për OSHC-të, por kjo formë financimi nuk përmendet të jetë ofruar në asnjë nga raportet e Agjencisë.

Përsa i përket transparencës dhe procedurave të financimit, në ligj dhe në Rregulloren e Procedurave të Agjencisë mbi Grantet, procedurat janë përshkruar qartësisht dhe në detaje në mbështetje të transparencës në çdo hap. Në praktikë, 46% e organizatave të vëzhguara u përgjigjen që pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin publik të financimit nuk është aspak transparente. Gjithashtu, OSHC-të konsiderojnë se procesi i vlerësimit dhe i përzgjedhjes nga AMSHC duhet të jetë më transparent.

Disa nga rekomandimet e OSHC-ve për të përmirësuar funksionimin e AMSHC, duke e bërë atë më mbështetëse ndaj sektorit, në përshtatje me rolin e saj siç është mandatuar në ligj, janë si vijojnë: rritja e monitorimit të jashtëm të AMSHC, rritja e mundësive të financimit për AMSHC, decentralizimi i AMSHC, riformulimi i strategjisë së AMSHC, ristrukturimi i brendshëm i AMSHC, përcaktimi i mekanizmave që lejojnë OSHC të aksesojnë në AMSHC, vendosja e kriterëve për shpërndarje gjeografike të fondeve të AMSHC për përfituesit, AMSHC duhet të ketë një rol koordinues

⁴¹⁾ Kjo e dhënë është vlerësuar bazuar në publikimin e AMSHC në faqen e saj më 2 prill 2013, meqë raporti për 2013 ende nuk është publikuar.

ndërmjet OSHC-ve, procedurat e aplikimit duhet të thjeshtëzohen dhe duhet të mënjahen burokracitë e panevojshme, AMSHC duhet të promovojë vullnetarizmin tek OSHC-të dhe aktorë të tjerë, fushat e mbështetjes duhet të zgjerohen. Ekzistenca e AMSHC duket se nuk është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e OSHC-ve për fondet publike, siç konfirmohet edhe nga vëzhgimi. Kur u pyetën nëse ka institucione shtetërore me mandat të qartë për shpërndarjen dhe monitorimin e fondeve publike, 62% e OSHC-ve u përgjigjën se këto institucione nuk ekzistojnë (31%) ose ka pak prej tyre (31%).

Në nivel lokal, OSHC-të mund të përfitojnë fonde publike përmes pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik. Në praktikë ka shumë sfida dhe vështirësi, duke e bërë pothuajse të pamundur për OSHC-të të përfitojnë fonde të tilla. Disa nga vështirësitë janë të lidhura me mungesën e informacionit dhe qartësisë së zyrtarëve publike mbi kuadrin ligjor për të prokuruar shërbime përmes OSHC-ve, kosto të lidhura me përgatitjen e dokumentave të tenderimit, trajtim i barabartë me bizneset, etj.. Duke marrë në konsideratë këto vështirësi, rezultojnë se ka një numër të vogël organizatash që përfitojnë nga këto procedura si në Vlorë, Durrës dhe Shkodër. Por edhe në këto raste, edhe pse procedura është zbatuar dhe fondet janë alokuar nga bashkitë respektive, financimi ka ardhur prej donatorëve dhe jo nga fondet publike. (UNDP në Durrës, dhe Reggio Emilia në Vlorë dhe Shkodër)⁴². Një nga rekomandimet e OSHC-ve për të rritur fondet nga qeveria lokale është replikimi i modelit të AMSHC në nivel lokal.

Financimi publik për bashkë-financimin e projekteve dhe programeve të BE-së (10-20% të bashkë-financimit) dhe granteve të tjera, nuk është praktikë në Shqipëri. Sikundër bashkë-financimi i programeve të BE është një nga vështirësitë kryesore me të cilat përballen OSHC-të shqiptare, që në shumë raste i pengojnë ato të aplikojnë për grante të tilla, një nga rekomandimet e OSHC-ve është që institucionet shtetërore dhe publike duhet të gjejnë forma të tjera alternative të mbështetjes për fondet e BE, të cilat do të përshpejtonin marrjen e këtyre fondeve.

Përpos fondeve publike, OSHC-të kërkojnë

mbështetje të tjera jo-financiare si: prona shtetërore, marrja me qera e hapësirave pa kompesim financiar, trajnim, konsultime dhe shërbime të tjera për OSHC-të. Ka raste të rralla të përfitimeve të tilla, ku bashkitë ofrojnë hapësira të lira për OSHC-të përmes marrëveshjeve 3-5 vjeçare duke përdorur pronat e tyre, ndërsa ka një mungesë të mbështetjes jo - financiare nga AMSHC.

Nën-fusha 2.3.: Burimet njerëzore

Vlerësimi i kësaj nën-fushe bazohet në standartet e mëposhtme: (i) OSHC-të trajtohen në një mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë, (ii) Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin, (iii) Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetar.

Legjislacioni Shqiptar lidhur me burimet njerëzore është i unifikuar për të gjithë punëdhënësit dhe aplikohet pa trajtim diferencial ndaj OSHC-ve. Ato trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe janë subjekt i kërkesave dhe detyrimeve të njëjta ndaj ligjit si punëdhënësit e tjerë pa asnjë diskriminim apo lehtësira. Politikat shtetërore mbi punësimin nuk konsiderohen stimuluese nga 55% e OSHC-ve të vëzhguara, 24% e tyre deklarojnë se janë disi stimuluese dhe 21% deklarojnë që këto politika janë neutrale. Pavarësisht numrit zyrtar për OSHC-të nga INSTAT dhe Njësisë së Intelgjencës Financiare, Shqipëria ende nuk ka një të dhënë zyrtare mbi numrin e të punësuarve në sektor. Përpos kësaj, në njoftimet e punësimit të publikuara nga ana e institucioneve shtetërore, eksperiencia e punës në sektorin e OSHC-ve nuk njihet si një përvojë e vlefshme e kandidatëve që do të merrej në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit.

Vullnetarizmi nuk është një praktikë e zakonshme, dhe shteti nuk e ka inkurajuar në mënyrë aktive zhvillimin e saj, për përfitime ose të drejta ligjore për vullnetarët⁴³. Më 5 dhjetor 2011, u prezantua projektligji mbi vullnetarizmin përgatitur nga institucionet publike në bashkëpunim me OSHC-të, por që nuk është miratuar ende në parlament. Nga ana tjetër, nuk ka programe shtetërore mbi vullnetarizmin. Paneli i eksperteve theksoi se nuk ka marrëveshje kontraktuale mes OSHC-ve dhe vullnetarëve që të përcaktojnë qartë rolin e vullnetarëve, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë

42) Resulte nga raportet përmbledhëse të seminareve rajonale mbi problemet e ndeshura në ofrimin e shërbimeve sociale, zhvilluar në Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Tiranë, nga Partnerët Shqiptarë.

43) USAID, Indeksi për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve 2011.

e tyre. Kontratat ekzistojnë vetëm në rastet kur vullnetarët vijnë nga programet e BE, si Shërbimit Vullnetar Evropian. Praktika që studentët kryejnë në organizatat e shoqërisë civile nuk janë stimuluar nga autoritetet shtetërore, pasi ajo është një praktikë e panjohur prej tyre.

Mungesa e ligjit mbi vullnetarizimin është konsideruar një problem për OSHC-të. Nuk ka incentiva financiare dhe morale për OSHC-të që kryejnë aktivitete bazuar në punë vullnetare, por ka detyrime ligjore për OSHC-të që të regjistrojnë dhe deklarojnë vullnetarët tek zyra e punësimit dhe të paguajnë siguracione, në të kundërt ka gjoba të rënduara.

Qëndrueshmëria e burimeve njerëzore, mbështetja e përgjithshme dhe besimi në shoqërinë civile mund të sigurohet nëpërmjet promovimit të angazhimit qytetar. Kjo arrihet përmes arsimit formal dhe jo-formal. Në arsimin formal, tema që lidhen me angazhimin qytetar janë të përfshira në kurrikulën e arsimit fillor dhe të mesëm, si pjesë e lëndës së edukimit qytetar, ndërsa në nivelin universitar këto tema janë pjesë e kurrikulës së fakulteteve të shkencave shoqërore.

Arsimi jo-formal është përshkruar në Ligjin Shqiptar për Arsimin Profesional si *“të mësuarit e planifikuar përmes aktiviteteve të organizuara, jo domosdoshmërisht të hartuara si lëndë mësimore, por që përmban përvojë të rëndësishme e të mësuarit”*. Në praktikë, OSHC-të janë të përfshira gjerësisht në arsimin joformal përmes ofrimit të trajnimeve dhe kurseve profesionale, dhe vetëm 24 OSHC kanë një licencë të dhënë nga autoritetet shtetërore për të siguruar edukimin profesional në të gjithë Shqipërinë⁴⁴. Mungesa e licencës nuk i ndalon OSHC-të të përfshihen në arsimin jo-formal, pasi ky aktivitet mund të ushtrohet me apo pa licencë, në përputhje me Ligjin për arsim profesional.

Edhe pse angazhimi qytetar është përfshirë në edukimit formal dhe jo-formal përmes shkollave dhe OSHC-ve, vetëm 22% e OSHC-ve të vëzhguara thonë se sistemi arsimor (formal dhe jo-formal) stimulon promovimin e angazhimit qytetar.

Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC

Nën-fusha 3.1.: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: (i) Shteti njëh, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin (ii) Shteti njëh, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të.

Bashkëpunimi dhe partneriteti midis OSHC-ve dhe qeverisë është i rëndësishëm për të krijuar një kuadër ligjor, politika dhe strategji për zhvillimin e sektorit. Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare për bashkëpunimin midis OSHC-ve dhe shtetit, edhe pse shumë nisma janë ndërmarrë nga sektori në lidhje me këtë çështje. Për tu përmendur është përgatitja e Kartës së Shoqërisë Civile në vitin 2009 nga një grup i përbashkët përfaqësuesish të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të qeverisë me mbështetjen e GTZ. Qëllimi i kartës është bashkëpunimi i mëtejshëm i partneritetit midis OSHC-ve dhe qeverisë në Shqipëri, në nivel qendror dhe lokal, për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe favorizues në mbështetje të një bashkëpunimi të frytshëm. Karta e Shoqërisë Civile përbën një dokument politik, dokument i cili njih publikisht Shoqërinë Civile si një aktor social kyç në shoqërinë shqiptare. Parimisht është mbështetur si nga shoqëria civile ashtu dhe nga qeveria, por nuk është miratuar për shkak të klimës së skajshme konfliktuale në Parlamentin dhe bojkotit të opozitës gjatë legjislaturës së fundit parlamentare (2009 -2013).

Të inkurajuar nga një përqasje e hapur dhe bashkëpunuese që demostroi qeveria e re, e cila erdhi në fuqi pas zgjedhjeve parlamentare të 2013, sektori i shoqërisë civile ka nisur dialogun mbi një seri çështjesh të përfshira në Kartë. Ato u bënë subjekt i konferencës kombëtare “Partnerë Socialë – Koha për Veprim”, si konferenca e parë e kërkuar nga shoqëria civile me qeverinë e re. Si rezultat i konferencës u shpall një deklaratë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Rishikimi dhe prezantimi i Kartës së Shoqërisë Civile për aprovim gjatë 2014 në Parlamentin Shqiptar ishte një nga kërkesat e deklaratës. Përpos kësaj, deklarata propozon mekanizma dhe forma të tjera që do të bëjnë të mundur bashkëpunimin efektiv dhe të qëndrueshëm midis shtetit dhe shoqërisë civile, siç është krijimi i Këshillit Kombëtar si një forum i cili do të mundësojë institucionalizimin e bashkëpunimit midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile.

44) <http://planipolis.iiep.unesco.org/upload/Albania/Albania-Strategy-Pre-university-2009-2013-alb.pdf>

Një çështje tjetër që qeveria shprehu hapësira për dialog është përmirësimi i strukturës, qëllimit, funksionimit jo-partizan, dhe transparencës së Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Mungesa e një strategjie kombëtare për bashkëpunim dhe partneritet midis dy sektorëve është shoqëruar me mungesën e strukturave në nivel lokal dhe qendror të qeverisjes, përgjegjëse për bashkëpunimin me OSHC-të. Në raste si Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ekziston një njësi, e cila mbulon bashkëpunimin me shoqërinë civile, por gjithmonë brenda qëllimit të Ministrisë. Si rezultat marrëdhënia midis qeverisë dhe shoqërisë civile ka qenë e dobët, sidomos rreth proceseve të hartimit të ligjeve. Ajo është vlerësuar si problematike edhe nga 82% e OSHC-ve që morën pjesë në vëzhgim.

Është për t'u theksuar se qeveria e re në muajt e fundit të vitit 2013 ka filluar procesin e emërimit të stafit të administratës publike në linjë ministrie, duke përfshirë Parlamentin për të mbuluar bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit. Ministria e Integritetit ka ngritur një strukturë të veçantë prej katër anëtarësh që mbulojnë marrëdhëniet me shoqërisë civile.

Nën – fusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: (i) Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendim-marrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur (ii) Të gjitha draft politikave dhe ligjet janë lehtësisht të qasshme për publikun në kohën e duhur (iii) Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutimet në organet ndër-sektoriale dhe janë zgjedhur nëpërmjet kriterëve dhe proceseve të përcaktuara qartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i legjislacionit dhe praktikës tregon se organizatat e shoqërisë civile operojnë pa kufizime, por me financim të kufizuar me një influencë të limituar në politikë-bërje⁴⁵. E drejta e qytetarëve dhe OSHC-ve për të marrë pjesë në proceset politike dhe në vendim-marrje nuk është një e drejtë e veçantë e garantuar nga legjislacioni shqiptar. Përkundrazi, kjo e drejtë buron nga parimet e përgjithshme të një sistemi politik demokratik, ligje të ndryshme dhe të drejta

të tjera të garantuara me Kushtetutë si: e drejta për të marrë informacion me rëndësi publike, e drejta për peticion ndaj autoriteteve publike, e drejta për një mjedis të shëndetshëm, e drejta për të propozuar ligje, e drejta e referendumit, liria e të shprehurit dhe shoqërimit, etj.. Përmes ushtrimit të këtyre të drejtave të garantuara me ligj, OSHC-të shqiptare kanë qenë të përfshira në nisma të hartimit të politikave, ligjeve dhe në vendim-marrje. Mund të përmendim: hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 2008, ligji për “Kodin e Familjes në Republikën e Shqipërisë”, ligji “ Për disa ndryshime në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë”, ligji “Për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, ligji “ për Barazinë Gjinore”, ligji “për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Plani Kombëtar i Përfshirjes së Romëve - Dekada e Romëve, politikave për mbrojtjen nga diskriminimi, etj..

Megjithatë, përfshirja e OSHC-ve në hartimin e politikave dhe vendim-marrjes janë karakterizuar nga spontaniteti, selektiviteti i pjesëmarrësve në proces duke përdorur kriteret politike, ose kufizimin e tij në faza të caktuara të procesit. Qeveria nuk ka një qëndrim zyrtar në këtë drejtim, ndërsa transparencja dhe qasja në informacione mbetet e dobët dhe problematike. Edhe pse ka raste kur qeveria bie dakord të konsultohet me OSHC-të, kjo ndodh për shkak të presionit ndërkombëtar. Për shembull, qeveria u konsultua me OSHC-të mbi Planin e Veprimit për adresimin e 12 Prioriteteve të KE-së kryesisht në përputhje me kushtet e KE-së. Nga një nismë mbi monitorimin e Komisionit Parlamentar të Integritetit Evropian (KPIE), të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN), gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, KPIE ka kryer gjithsej 39 takime për diskutimin e 28 projektligjeve dhe 1 akti normativ, nga të cilat vetëm në një rast u ftuan të marrin pjesë grupet e shoqërisë civile.

Kjo mbështetet edhe nga rezultatet e këtij raporti monitorues. Kur u pyetën se si e vlerësonin nivelin e përfshirjes së OSHC-ve në nisma të vendim-marrjeve, 47% e OSHC-ve vlerësuan të ulët nivelin e përfshirjes së OSHC-ve në vendim-marrje. Disa nga kriteret që do të mundësojnë një pjesëmarrje dhe përfshirje më të madhe të OSHC-ve në vendim-marrje janë, por nuk limitohen në rritje

45) Freedom in the world 2013, Freedom House


të ekspertizës së OSHC-ve në fushat e tyre të punës, procese pjesëmarrëse transparente dhe gjithëpërfshirëse, garantimi me ligj i të drejtës për të marrë pjesë, krijimi dhe funksionimi i strukturave dhe mekanizmave shtetërore që mbështesin pjesëmarrjen e publikut, përmirësimi i klimës së bashkëpunimit mes grupeve të shoqërisë civile dhe qeverisë të pandikuar nga preferencat dhe ndikimet politike. Në nivelin e rregulloreve ligjore, një nga rekomandimet është hyrja në fuqi e normave detyruese për institucionet qendrore dhe lokale në lidhje me konsultimin me OSHC-të në të gjitha fushat që përbëjnë interesin publik.

Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet Zyrtare”, garanton të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare dhe përcakton procedura të qarta për qasje të informimit publik, kushtet, përjashtimet dhe afatet që duhet të përmbushen nga autoritetet publike në përgjigje të kërkesave të qytetarëve në dokumente publike. Por, nuk ka rregulla apo procedura detyruese për autoritetet publike që i detyrojnë ata të publikojnë draft politikat dhe projektligjet, për t'i vënë në dispozicion të publikut. Edhe kur proceset konsultative zhvillohen ato janë të fragmentuara, nxitur kryesisht nga vullneti politik i udhëheqjes së institucionit dhe kryesisht të kushtëzuar dhe të mbështetur nga ndihma e huaj. Një shembull ilustrues është projekti i UNDP-së “Aplikacionet e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në qeverisjen lokale dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve”. (2010-2012), i zbatuar në bashkitë Kamëz, Elbasan dhe Tiranë. Pas përfundimit të projektit, faqet zyrtare të këtyre bashkive nuk janë

përditësuar, duke ndaluar së shërbyeri qëllimit të tyre primar në funksion të e-pjesëmarrjes dhe e-konsultimit. Bazuar në këtë realitet, qasja publike në draft politika dhe ligje konsiderohet e vështirë nga 45 % e OSHC-ve dhe shumë e vështirë nga 18% të tyre. Disa nga kushtet e sugjeruara që do të mundësonin qasjen e publikut në draft politika dhe ligje janë: publikime on-line dhe të shtypura, rregulla të detyrueshme për të publikuar çdo ligj dhe politikë, përditësimet e rregullta të informacionit on-line dhe formate miqësore për lexuesit, afate të qarta dhe të arsyeshme për dorëzimin e komenteve në lidhje me projektligjet, ftesa për seancat dëgjimore publike të dërguara tek OSHC-të, përdorimi i mediave dhe rritja e transparencës.

Në lidhje me çështjen e OSHC-ve si partnerë të barabartë të përfaqësuar në organet këshilluese nuk ka një ligj specifik që rregullon këtë çështje, por në ligje të ndryshme është sanksionuar krijimi i organeve këshillimore. Një shembull është Ligji mbi Barazinë Gjinore në Shoqëri, i cili parashikon krijimin e një organi këshillimor, siç është Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore, i kryesuar nga ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore. Ai është i përbërë nga dhjetë përfaqësues të përcaktuar nga Qeveria dhe tre nga shoqëria civile. Duke qenë pakicë në këto organe, shoqëria civile e ka të vështirë të ndikojë në nisma të politikës. Vëzhgimi tregon se organe / struktura të tilla njihen vetëm nga 44% e OSHC-ve, ndërsa 27% e tyre nuk janë në dijeni të ekzistencës së këtyre strukturave. Pjesëmarrja në organet këshilluese është konsideruar si një proces i lehtë vetëm nga 18% e OSHC-ve (Grafiku 9).

Grafiku 9. Procesi i përfaqësimit të OSHC-ve në strukturat e planifikimit ndërsektorial.



Procedurat e përzgjedhjes së OSHC-ve në këto struktura janë konsideruar të paqarta dhe jo-transparente nga 57% të OSHC-ve. Disa nga kriteret që do të sigurojnë një partneritet efektiv përfshijnë: transparencë, besim, bashkëpunim, profesionalizëm, komunikim dy palësh dhe të qëndrueshëm në bazë të rregullave dhe procedurave të qarta.

Një faktor kontribues në përmirësimin e partneritetit do të jetë krijimi i Këshillit Kombëtar për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile. Këshilli synon të ketë përfaqësim të barabartë midis përfaqësuesve të qeverisë dhe OSHC-ve.

Nën-fusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: (i) OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe të konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë (ii) Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afatgjatë (iii) Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të (iv) Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve

Siç është adresuar në Indeksin e Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2012, të USAID *“shumë OSHC me përvojë dhe burime, bazuar kryesisht në kryeqytet, ofrojnë grupe të ndryshme shërbimesh dhe konkurrojnë për kontrata për të siguruar ndërtimin e kapaciteteve, vlerësimin, dhe shërbimet e monitorimit”*. Bazat kryesore ligjore për OSHC- të që ofrojnë shërbime të tilla përfshijnë: Ligjin për Organizatat Jofitimprurëse, sipas së cilit OSHC-të ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe shërbim të publikut, dhe kur ushtrimi i një aktiviteti paraqet kërkesa, ato mund të marrin licencë nga autoritetet kompetente shtetërore; Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në bazë të të cilit OSHC-të mund të ofrojnë shërbime sociale të financuara privatisht, si dhe shërbime publike me financim nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet e pavarura të Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV). Për të ofruar shërbime të kujdesit social, OSHC-të

duhet të pajisen me një licencë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, si të gjithë personat juridikë publikë apo privatë që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror. Kur u pyetën mbi vlerësimin e procesit të marrjes së licencës, ekziston një ndarje pothuajse e barabartë ku 31 % e OSHC-ve e konsiderojnë procedurën të vështirë (16% nuk është aspak e lehtë dhe 15 % pak e lehtë), 33% e konsiderojnë disi të lehtë, ndërsa 36 % e konsiderojnë të lehtë (19 % e lehtë dhe 17 % shumë e lehtë).

Për të ofruar shërbime publike të kujdesit social, OSHC-të duhet të konkurrojnë në mënyrë të barabartë me ofruesit e tjerë të shërbimeve, në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin e Prokurimit Publik. Konkurrenca me sektorin privat, me të njëjtat kriterë, ku kriteri kryesor dhe i vetëm i vlerësimit të ofertave është çmimi, duke mos marrë parasysh ekspertizën dhe cilësinë e shërbimit, i vendos OSHC-të në një situatë të disfavorshme, duke rezultuar që një numër i vogël OSHC-sh përfitojnë fonde të prokurimit publik. Siç dëshmohet edhe nga vëzhgimi, 75% e OSHC-ve nuk kanë të ardhura nga prokurimet publike dhe 53% nuk mund të përfitojnë nga kontratat shtetërore. Vetëm 8% e OSHC-ve thonë se mund të përfitojnë shumë, dhe këto vijnë nga qytetet e mëdha si Tirana, Elbasani, Shkodra, dhe Fieri, ku fondi publik për shërbimet sociale është i disponueshëm dhe kapacitetet e OSHC-ve janë më të larta.


Gjatë këtyre viteve, mundësitë e financimit nga shteti kanë qenë të ulëta dhe qeveritë kanë dështuar për të kontraktuar OSHC-të për një strategji gjithëpërfshirëse për të përkrahur zhvillimin e shoqërisë civile, siç thuhet edhe nga 70% e OSHC-ve të cilat deklaruan se nuk përfitojnë nga fondet e shtetit për shërbimet publike. Në rastet kur ndodh, kontraktimi i OSHC-ve nga shteti është i kufizuar në shërbimet sociale bazë që kanë të bëjnë me ri-integrimin e personave në nevojë, si viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje, ose integrimi i Romëve.

OSHC-të që kanë patur përvoja në aplikimin dhe përfitimin nga fondet e shtetit në nivel lokal dhe qendror, ballafaqohen me disa sfida duke e bërë të vështirë për ta aplikimin dhe zbatimin e suksesshëm të projektit (për ata që kanë pasur sukses). Disa prej sfidave janë:

- Mungesa e informacionit dhe qartësisë midis zyrtarëve publik, përgjegjës për prokurimin, lidhur me kornizën ligjore dhe procedurat teknike për pjesëmarrjen e OSHC-ve në procedurat e prokurimit. Kjo vërehet sidomos në nivel lokal, ku ndodhin shumica e këtyre procedurave, pasi shërbimet janë të decentralizuara. Nga ana tjetër, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për OSHC-të, siç është raportur gjatë takimeve konsultative dhe informative që Partnerët Shqipëri ka organizuar me OSHC-të në disa qytete.
- Fondi është disbursuar në fund të projektit, duke e bërë të vështirë implementimin e tij për OSHC-të të cilat nuk kanë likuiditete për të mbuluar shpenzimet. Në disa raste, siç është raportuar nga OSHC-të, financimi nuk mbulon kostot administrative të organizatës, të nevojshme për zbatimin e projektit.
- Procesi i tenderit është shumë i vështirë, shpenzimet për përgatitjen e dokumenteve të kërkuara janë të larta dhe OSHC-të nuk kanë likuiditete për të mbuluar këto shpenzime. Vetëm 12 % e OSHC-ve të anketuara thonë se procedurat kontraktuese (duke përfshirë zbatimin) janë të lehta.
- Në disa raste, fondi i marrë ka rezultuar më i vogël se ai i deklaruar në procedurën e tenderimit.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit nga bashkia e Shkodrës, gjatë një seminari rajonal të zhvilluar nga Partnerët Shqipëri mbi problematikën e ofrimit të shërbimit social, janë shprehur që ka mungesa në ligjin mbi shërbimet sociale që e bëjnë më të vështirë aplikimin dhe kontraktimin e OSHC-ve. Ndërsa në bashkinë e Durrësit, autoritetet kanë bërë disa ndryshime për të lehtësuar procedurat dhe zbatimin e efektshëm të projekteve nga OSHC-të.

Grafiku 10. Publikimi i rezultateve të monitorimit të ofruesve të shërbimit



Gjatë zbatimit të projekteve me fondet publike, rezulton se OSHC-të nuk janë subjekt i kontrollit të tepruar nga autoritetet shtetërore dhe monitorimi është bërë me njoftim paraprak në shumicën e rasteve, ndërsa rezultatet e monitorimit nuk ndahen me OSHC-të. (Grafiku 10)

Disa nga rekomandimet që do të lehtësonin kontraktimin e OSHC-ve për shërbimin publik lidhen me: transparencën në procedurën e tenderimit; procedura të thjeshtëzuara;

infrastrukturë ligjore e përmirësuar; lehtësira fiskale; dhe përzgjedhjen e OSHC-ve bazuar në fushën e tyre të ekspertizës.

Shqyrtimi i rekomandimeve të mësipërme çon në nevojën për ndryshime ligjore dhe futjen e kontraktimit social si një praktikë e re që do të mundësonte bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale drejt shërbimeve më të mira për qytetarët.

Gjetjet dhe Rekomandimet (Tabela)

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën -fusha 1.1: Liria e organizimit

Parimi: Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARTET <small>HAFAT E MATJESË PROGRESIT</small>	INDIKATORËT	GIETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një kuadër ligjor sipas të cilit çdo person mund të krijojë shoqata, fondacione dhe lojë të tjera subjektsh jo-ftimprurëse, jo-qeveritare (p.sh. kompani jo-ftimprurëse) për çfarëdo qëllimi. 2) Kuadri ligjor lejon si personat juridikë dhe individët të ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim (moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie, etj). 3) Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe në rastet kur organizatat vendosin të regjistrohen, rregullat e regjistrimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë që të lejojnë një proces regjistrimi dhe apelimi të lehtë, jo shumë të gjatë në kohë dhe të pakushtueshëm. 4) Ligji lejon për krijimin e rrjeteve midis organizatave në vendet e tyre dhe jashtë, pa njoftim paraprak. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Çdo person fizik apo juridik në praktikë mund të formojë shoqata, fondacione apo forma të tjera organizimesh jo-ftimprurëse, jo-qeveritare offline apo online. 2) Personat fizikë dhe juridikë nuk sanksionohen për mos-regjistrimin e organizatave të tyre. 3) Regjistrimi është me të vërtetë i arritshëm brenda afateve të përcaktuara me ligj; autoritetet vendosin mbi rastet në mënyrë jo-subjektive dhe apolitike. 4) Individët dhe OSHC-të mund të formojnë dhe të marrin pjesë në rrjete dhe koalicione, brenda dhe jashtë vendit të tyre. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Çdokush mund të ushtrojë të drejtën e tij për të themeluar organizata, fondacione dhe qendra (tre lojë të OSHC-ve që njihen nga Ligji i Organizatave Jo Ftimprurëse). 2) Liria e organizimit është një e drejtë kushtetuese për çdo individ dhe subjekt juridik pa diskriminim me bazë moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie apo etnie. 3) Regjistrimi i OSHC-ve nuk është i detyrueshëm dhe në rastet kur OSHC-të vendosin të regjistrohen, rregullat dhe procedurat e regjistrimit janë të vendosura e të parashikuara qartësisht në Ligj. Procesi i regjistrimit të OSHC-ve është i centralizuar dhe regjistrimi mund të bëhet vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë. 4) Kuadri ligjor është shumë tolerant për krijimin e rrjeteve si brenda ashtu edhe jashtë vendit pa njoftim paraprak. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e OSHC-ve dhe regjistrimi i OSHC-ve nuk mund të kryhet online. 2) Nuk aplikohen sanksione për OSHC-të e parregjistruara. Regjistrimi në Tiranë konsiderohet si një barrierë për OSHC-të të cilat e kanë qendrën në rrethe për shkak të kostove dhe kohës shtesë që nevojitet. 3) Procesi i regjistrimit është i thjeshtë, duke lejuar kështu një regjistrim të drejtë të OSHC-ve. 4) Pjesëmarrja e individëve në organizata formale e joformale është e lehtë dhe praktikisht, individët dhe OSHC-të mund të marrin pjesë në rrjetëzime dhe koalicione brenda dhe jashtë vendit të tyre. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Decentralizim i procesit të regjistrimit të OSHC-ve <p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nevojiten të dhëna zyrtare për numrin e OSHC-ve të regjistruara. 	

1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të themelohin, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirisht në organizata jo-formale apo të regjistruara, offline dhe online

Nën – fusha 1.1.: Liria e organizimit

Parimi: Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
2. OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kuadri ligjor ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-ftimprurëse. Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrje të palëve të treta. Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pastrimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit konsiderojnë natyrën specifike të OSHC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj. Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit. Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen plotësojnë standardet e ligjeve ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kritere objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nuk ka raste të ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-ftimprurëse. Nuk ka praktika të mbikëqyrjeve okupuese të cilat të imponojnë kërkesa të rënduara raportimi. Sanksionet aplikohen në raste të rralla / ekstreme, ato janë proporcionale dhe janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji mbi Regjistrimin e Organizatave Jo-Fitimprurëse përcakton të drejtën e OSHC-ve për të vepruar pa ndërhyrjen e shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme. Në ligj nuk ka dispozita të veçanta lidhur me këtë çështje. Rregullat e raportimit dhe llogarive financiare nuk marrin parasysh natyrën specifike të OSHC-ve dhe nuk janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin/qëllimin e aktiviteteve të saj. Sanksionet për cënimin e kërkesave ligjore nuk ndjekin parimin e proporcionalitetit. Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen janë qartësisht të parashikuara nga ligji për regjistrimin e organizatave jo-ftimprurëse. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Në përgjithësi nuk ka raste të ndërhyrjes së shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC-ve Ka raste të presionit politik nga qeveria mbi OSHC-të që luajnë një rol monitorues (watchdog), duke keqpërdorur ligjet mbi inspektimin financiar, menaxhimin dhe kontrollin financiar. Sanksionet aplikohen në raste të rralla ose nuk aplikohen fare. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i legjislacionit aktual të taksave dhe financave përmes një kuadri të veçantë për sektorin e OSHC-ve, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të sektorit, masën e organizatës dhe qëllimin/lojin e aktivitetit të saj.

Nën – fusha 1.1.: Liria e organizimit

Parimi: Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
3. OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni lejon OSHC-të të angazhohen në aktivitetet ekonomike. OSHC-të lejojnë të marrin fonde të huaja. OSHC-të lejojnë të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse i lejon OSHC-të të përfshihen direkt në aktivitetet ekonomike, por sipas kodit civil ato nuk lejojnë të realizojnë aktivitetet ftimprurëse; kështu që duket se ka një keqkuptim të përgjithshëm të faktit se çfarë do të thotë aktivitet ftimprurës. Sipas ligjit mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse, burimet e të ardhurave për OSHC-të janë nga kuotat e anëtarësimit, kur ekzistojnë të tilla, grante e donacione të ofruara nga subjekte publike apo private, lokale apo të huaja, si edhe të ardhura nga aktiviteti ekonomik dhe asetet që organizata jo-ftimprurëse zotëron. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Sqarime ligjore për diferencimin mes aktivitetit ekonomik dhe jo-ekonomik të OSHC-ve

<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Format i ndryshëm raportimi për aktivitetet ekonomike dhe jo-ekonomike të OSHC-ve. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Raportimi i aktiviteteve ekonomike dhe jo-ekonomike me format të njëjtë është jo-efektive dhe përbën barrë për OSHC-të. Tarifat dhe ngarkesat e transaksioneve bankare të cilat nuk lejohen si kosto të buxhetit, janë disa nga kufizimet financiare për marrjen e financimeve të huaja Niveli i zvogëlimit të taksave nuk është mjaftueshëm inkurajues për dhurimet që individët dhe korporatat i bëjnë OSHC-ve 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni për OSHC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OSHC-të. Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, pre-miratim, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OSHC-të për të marrë fonde të huaja. Marrja e financimit nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative.
--	--	--

Nën -fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kuadri ligjor është i bazuar në standartet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë pa asnjë diskriminim. Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane. Ushtrimi i së drejtës nuk është subjekt për autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta për një procedurë njoftimi paraprak, e cila nuk është e rëndë. Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apelohej nga organizatorët. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kuadri ligjor garanton të drejtën për të ushtruar lirinë e organizimit paqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të specifikuar me ligjin e Tubimeve Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane dhe kundër-organizimet. Ligji rregullon procedurat e njoftimeve paraprake në rastet kur mbledhjet realizohen në hapësira publike apo rrugë publike. Kur këto organizime planifikohen në hapësira publike të hapura, ato mundën ta realizojnë këtë edhe pa njoftim paraprak në polici. Ligji parashikon të drejtën e apelit administrativ nga organizatorët. 	<p>Legjislacioni:</p>
<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore. Kufizimet janë të justifikuara me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e apelit. Mbledhjet simultane, spontane mund të kryhen, dhe shteti lehtëson dhe mbrojnë grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen. Ka raste të lirisë së mbledhjes të praktikuar nga OSHC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, kur njoftimi nevojitet ai dorëzohet në një periudhë të shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar mbledhjen. Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve. Media duhet të ketë qasje sa më të madhe nëpër mbledhje. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Në praktikë respektohet e drejta për të ushtruar lirinë e organizimeve paqësore. Tubimet organizohen në përputhje dhe duke respektuar ligjin dhe rolin e policisë ka qënë mbështetës. Nuk ka raste të organizimeve e takimeve pa lajmërim paraprak në polici. Nuk ka raste të ndërhyrjes së policisë gjatë tubimit. Media është e pranishme në organizimet paqësore 	<p>Praktika:</p>

1. Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore.

Nën-fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Korniza ligjore siguron lirinë e shprehjes për të gjithë. 2) Kufizimet, të tilla si kufizime të të folurit me urrëjtje, të imponuara nga legjislacioni janë të përshkruara qartë dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. 3) Shpifja përbën më tepër një kundrarvojte se sa pjesë e kodit penal. <p>2. Përfaqësuesit e OSHC, individualisht apo përmes organizatave, gëzojnë lirinë e shprehjes.</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shqipëria ofron sigurinë kushtetuese dhe ligjore të së drejtës së qytetarëve për t'u shprehur lirish 2) Kufizime të tilla si kufizimet e të folurit me urrëjtje të imponuara nga legjislacioni, janë të përshkruara qartë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë 3) Shpifja rregullohet në Kodin Penal, pavarësisht përplekëve në vitin 2012 për ta përfshirë atë në kodin civil 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpifja në shkrime dhe fjalime duhet të përfshihet në Kodin Civil, në vend që të jetë pjesë e kodit Penal
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përfaqësuesit e OSHC, sidomos organizatave për të drejtat e njeriut dhe ëatch dog, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes në çështje që ata mbështesin dhe ndaj të cilave janë kritikë. 2) Nuk ka raste të shkeljes së të drejtës së lirisë së shprehjes për të gjithë. 3) Nuk ka raste ku individë, duke përfshirë përfaqësues të OSHC-ve do të persekutoheshin për fjalime kritike, në publik apo private. 4) Nuk ka asnjë sanksion për fjalimin kritik, në publik apo privat, sipas kodit penal. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Në praktikë OSHC-të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes pa ndonjë ndërrhyrje, duke qënë se ato lejohen të organizojnë seminare, konference apo evente të tjera publike për të diskutuar çështje të ndryshme, për të marrë pjesë dhe për të shprehur këndvështrimet dhe opinionet e tyre në median e shkruar, elektronike dhe sociale, edhe në rastet e kritikave ndaj qeverisë. 	<p>Praktika:</p>

Nën-fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
3. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, individualisht dhe përmes organizatave të tyre, kanë të drejtën për të marrë dhe ndarë informacion të sigurtë përmes çdo media	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kuadri ligjor ofron mundësinë për të komunikuar nëpërmjet dhe për të patur akses në çfarëdo burim informacioni, duke përfshirë internetin dhe Teknologjinë e Komunikimit të Informacionit (ICT); nëse ka kufizime ligjore këto janë të rralla, të kufizuara dhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. 2) Kuadri ligjor ndalon monitorimin pajustifikuar të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë internetin dhe ICT, ose mbledhjen e informacionit të përdoruesit nga ana e autoriteteve. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni Shqiptar përmbush kërkesat kryesore në mënyrë që të lehtësojë dhe mbështesë implementimin dhe përmirësimin e teknologjive, shërbimeve dhe rregulloreve të reja në sektorin shqiptar të TIK. 2) Shqipëria ende vuan nga përqindja e ulët e ndërfutjes së linjave dhe internetit, përqindje e ulët e zotërimit të kompjuterave, kostovet të larta të internetit dhe aksesit e shërbimeve nëpërmjet celularëve, nivel i ulët i ndërgjegjësimit për përfitimet e përdorimit të TIK, hendeku dixhital midis zonave urbane e rurale dhe krahasuar me vende të tjera në Evropë, nivel i ulët i subvencioneve shtetërore dhe mungesë politike kash për t'i mbështetur ato. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i shërbimeve të rrjetit edhe në zonat rurale • Rishikimi i ligjit mbi koston e internetit dhe shërbimet e aksesit në celularë. • Politika publike për zhvillimin e TIK.

<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste në praktikë, ku janë vendosur kufizime mbi qasjen e çfarëdo burimi informacioni, përfshirë internetin apo ICT. 2) Interneti është gjerësisht i arritshëm dhe i përballeshëm. 3) Nuk ka asnjë praktikë apo raste monitorimi të pajustifikuar nga ana e autoriteteve, të kanaleve të komunikimit duke përfshirë internetin apo ICT, ose mbledhjes së informacionit të përdoruesit. 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve të rrjeteve sociale nga ana e policisë. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Në praktikë nuk ka raste ku të jenë imponuar kufizime në aksesimin e ndonjë burimi informacioni, përfshirë edhe internetin apo TIK. 2) Interneti është gjerësisht i aksesueshëm dhe i përballeshëm nga OSHC-të në zonat rurale dhe në qytetet e mëdha, ndërkohë që OSHC-të në zonat e thella rurale, kanë vështirësi në aksesimin e internetit dhe pagesën gjë që ndikon në ekzistencën e tyre dhe në veprimtarinë e tyre efektive. 3) Nuk ka praktika apo raste të monitorimit të pajustifikuar të kanaleve të komunikimit nga autoritetet, duke përfshirë internetin apo TIK, apo mbledhjen e informacionit të përdoruesve. 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve e rrjeteve sociale nga ana e policisë. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nevojitet shtrirja e internetit në zonat rurale. • Çmime të përballeshme për OSHC-të e vogla dhe ato në zonat rurale
--	---	---

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nëntfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.

Parimi: OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>1. Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligji parashikon trajtim tatimor falas për të gjithë grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-ftimprurës të OSHC-ve. 2) Ligji siguron përfitime tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve. 3) Ligji siguron përfitime tatimore për investimet pasive të OSHC-ve. 4) Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për Fondet e Dhurimeve të Kushtëzuara 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligji mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse përcakton se OSHC-të janë të përjashtuara nga taksat mbi të ardhurat të realizuara nga dhurimet dhe tariffat e anëtarësimit dhe duket se grantet nuk janë të përfshira në përjashtimin nga taksat. Lënia jashtë e tyre, mund të çojë në interpretime jo korrekte nga autoritetet të ndryshme shtetërore, donatorë dhe OSHC në Shqipëri. 2) Aktiviteti ekonomik i OSHC-ve është subjekt i taksës 10% mbi fitimin (e ngjashme me kompanitë e taksuara me të njëjtën masë për përfitimet e tyre). OSHC-ve u kërkohet të raportojnë nën sistemin e TVSH-së edhe nëse formalisht ato nuk kanë xhiron e duhur për një aktivitet ekonomik. 3) OSHC-të në Shqipëri lejohen të përfshihen në investime pasive, por ato trajtohen në të njëjtën mënyrë si aktivitetet e biznesit dhe janë respektivisht të taksuara pa përjashtime nga legjislacioni i taksave (përveç interesit bankar). 4) Përfitimet tatimore nga dhurimet e kushtëzuara nuk aplikohen sepse Shqipëria nuk ka ndonjë ligj që e rregullon këtë çështje. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullimi i legjislacionit fiskal për OSHC-të. • Rishikim i legjislacionit lidhur me përfitimet e qartë të granteve nga skema e taksave. • Rishikim i regjimit të taksave për aktivitetin ekonomik. • Përfshirja nga skema e TVSH ose reduktimi i vlerës së TVSH për OSHC-të.
<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet direkte ose indirekte (e fshehur). 2) Përfitimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OSHC-ve. 3) Investimet pasive janë shfrytëzuar nga OSHC-të dhe nuk janë aplikuar sanksione për të tilla investime. 4) Dhurimet e kushtëzuara që mundësojnë gjenerimin e të ardhurave (Erdëimants) janë krijuar pa vështirësi të mëdha procedurale dhe vepronë lirisht, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Raportohen raste të aplikimit të taksës mbi grantet, por rezultoni se kjo është rezultat i një kërkesë nga ana e donatorëve, dhe jo nga autoritetet shtetërore. 2) Nuk ka përfitime efektive nga taksat për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve që mbështesin veprimtarinë e OSHC-ve. 3) Investimet pasive nuk përdoren nga OSHC-të 4) Nuk ka praktika për dhurimet e kushtëzuara. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qartësimi në nivel praktik lidhur me përjashtimin e granteve nga taksimi që do të pasojë edhe amendimet ligjore. • Rimbursimi i TVSH 	

Nënfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.

Parimi: OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji parashikon zbritje nga taksat për dhurime individuale apo nga korporatat për OSHC-të. Ka kërkesa/ kushte të qarta për marrjen e dhurimeve për të cilat ka ulje nga taksat dhe këto përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh në dobi të publikut. Politikat shtetërore në lidhje me përgjegjshmërinë sociale (CSR) marrin në konsideratë nevojat e OSHC-ve dhe i përfshijnë ato në programet e tyre. <p>2. Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Bazuar në Ligjin e Sponsorizimit, donatorë konsiderohen vetëm individët dhe kompanitë e biznesit që kanë cilësinë e "shtetit", duke përjashtur në këtë mënyrë punonjësit. Niveli i zbritjeve tatimore nuk është mjaftueshëm inkurajues për dhurimet që individët dhe korporatat i bëjnë OSHC-ve Shqipëria ka hartuar Planin Kombëtar të Veprimit dhe treguesit përkatës mbi përgjegjshmërinë sociale të korporatave (PSK), janë krijuar Forumet me grupe të ndryshme interesi PSK dhe përshtatjen e standardeve ISO 260000 <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Procedurat për të kërkuar zbritje taksash nuk janë funksionale dhe nuk inkurajojnë dhurimet individuale dhe të korporatave. OSHC-të po luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e PSK. Nuk ka ulje specifike taksash për këto lloj organizatash. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i ligjit mbi sponsorizimin për më tepër stimuj/lehtësira për dhurimet, si edhe lehtësimi i procedurave për rimbursimin Zhvillimi i përgjegjshmërisë sociale të korporatave përmes politikave publike kombëtare <p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i stimujve që do të ulin barrën e taksave për ndërmarrjet në mënyrë që ato të kryejnë aktivitete filantropike Konsultimi i OSHC-ve mbi promovimin e PSK Njohja e dhurimeve (bëria e tyre publike dhe e dukshme)

Nënfusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Parimi Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
1. Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE.	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE. Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të. Fondet publike për OSHC-të janë planifikuar në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit. Ka procedura të qarta për plesëmarrjen e OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare (dokument) që rregullon mbështetjen e shtetit për zhvillimin institucional të OSHC-ve dhe që targeton shoqërinë civile si një e tërë. Fondet sigurohen vetëm nëpërmjet mekanizmit kombëtar që ka një mandat për shpërndarjen e fondeve publike tek OSHC-të dhe kjo është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Fushat prioritare të AMSHC-së vendosen në përputhje me prioritetet e qeverisë shqiptare dhe nuk janë të bazuara në konsultime me sektorin e OSHC-ve Ligji dhe rregulloret e procedurave të financimit të agjencisë me grante janë të parashikuara qartësisht dhe në detaje, në mbështetje të një procesi transparent në të gjitha hapat e saj 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pregatitja dhe miratimi i strategjisë kombëtare që rregullon mbështetjen e shtetit për zhvillimin institucional të OSHC-ve Ristrukturimi i AMSHC-së për të përmirësuar funksionimin e tij, bëria e tij më mbështetës për sektorin në përputhje me rolin e tij të përcaktuar me ligj

<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të OSHC-ve. 2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose monitorimin e shpërndarjes së fondeve shtetërore. 3) Financimi është i parashikueshëm, jo i prerë në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shumica e buxhetit për OSHC është lehtësisht e identifikueshme. 4) Pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplote. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Mbështetja e shtetit përmes financimeve publike nuk i përgjigjet nevojave të OSHC-ve. 2) Përfaqësuesit e OSHC-ve në bordin mbikëqyrës të AMSHC-së janë "aktivist të shoqërisë civile pro qeverisë", gjë që ndikon në paanësinë e agjencisë. Organizatat dhe lëvizjet monitoruese (watchdog) që kritikojnë politikat e qeverisë e kanë të pamundur të marrin mbështetjen e Agjencisë. 3) Bashkë-financimi i programeve dhe projekteve të BE-së nuk është praktikë e shpërndarjes së fondeve. 4) Pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik nuk është transparent. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e monitorimit të jashtëm të AMSHC-së • AMSHC duhet të ketë një rol koordinues mes OSHC-ve • Rritja e mbështetjes së shtetit për bashkë-financime me fondet e BE-së • Vendosja e mekanizmave për rritjen e transparencës së financimit publik të OSHC-ve
---	---	---

Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Parimi: Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>2. Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjrisht detyruese për palët. 2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht. 3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike, siç parashihet në ligjin e AMSHC-së dhe rregulloren e tij të brendshme, lejon një procedurë transparente dhe ligjrisht detyruese 2) Lista e kriterëve publikohet gjatë shpalljes së thirrjeve për projekt propozime 3) Procedurat që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje janë të parashikuara në ligjin e AMSHC-së. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurat e aplikimit duhet të thjeshtëzohen dhe burokracitë e panevojshme duhen eliminuar.
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Informacione lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në dispozicion të publikut. 2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar. 3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OSHC-të. 4) Vendimet mbi tenderat konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit janë shpallur paraprakisht. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Informacionet shpallen publikisht në faqen e internetit të autoriteteve kompetente dhe/ose në gazeta të përditshme. 2) Fushat dhe shumat e fondeve të shpërndara janë qartësisht të parashikuara në raportin vjetor të AMSHC-së, por mungon impakti i projekteve të financuara. 3) Procedurat e aplikimit nuk janë të thjeshtëzuara dhe OSHC-të përballen me burokraci të panevojshme. 4) Vendimet mbi tenderat nuk konsiderohen të drejta dhe transparente. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurat e aplikimit duhet të thjeshtëzohen dhe burokracitë e panevojshme duhen eliminuar.

Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Parimi: Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
3. Ka një sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike parashikon masa të qarta për llogaridhënien, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. 2) Ka sanksione për OSHC-të që keqpërdorin fondet dhe ato janë në proporcion me shkëlqen e procedurës. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Monitorimi kryhet vazhdimisht dhe në përputhje me indikatorët objektivë dhe të paracaktuar. 2) Vlerësimi i rregullt i efektit të fondeve publike kryhet nga organet shtetërore dhe është në dispozicion të publikut. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike dhe sanksioneve janë të parashikuara në ligjin e AMSHC-së <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Monitorimi realizohet nga AMSHC gjatë implementimit të projektit, por pa standarde të konsoliduara. 2) Nuk realizohet vlerësimi i rregullt i efektit/impaktit të fondeve publike nga AMSHC. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i një rregulloreje me sistem të qartë përgjegjësie, monitorimi dhe vlerësimi. <p>• Më tepër vlerësime mbi impaktin e projekteve.</p>

Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Parimi: Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
4. Ekziston mbështetja jo-financiare nga shteti	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni lejon autoritetet shtetërore të alokojnë mbështetje jo-financiare, si psh. pronë shtetërore, marrje me qera të hapësirës pa kompensim financiar (kohor), trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OSHC-të. 2) Mbështetja jo-financiare ofrohet në bazë të proceseve të paracaktuara në mënyrë të qartë, duke u bazuar në kritere objektive dhe pa privilegjuar asnjë grup. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) OSHC përdorin mbështetje jo-financiare nga shteti. 2) OSHC trajtohen në mënyrë të barabartë ose përfitojnë më shumë mbështetje në krahasim me aktorët e tjerë, kur ofrojnë burime jo-financiare shtetërore. 3) Nuk ka raste të autoriteteve shtetërore që ofrojnë mbështetje jo-financiare vetëm për OSHC-të që nuk kritikojnë punën e tyre; ose e rasteve të privimit të mbështetjes për OSHC-të kritike; ose diskriminim tjetër bazuar në besnikërinë, përkatësinë politike ose terma të tjera të paligjshme. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni i lejon autoritetet shtetërore të ofrojnë mbështetje jo-financiare, si pronat shtetërore, dhënia me qira e hapësirave pa ose me kompensim financiar të reduktuar 2) Nuk ka procedura/udhëzime për mbështetjen jo-financiare 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i procedurave/udhëzimeve të qarta për mbështetjen jo-financiare të shtetit. <p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e mbështetjes jo-financiare për OSHC-të • Rritje e rolit të AMSHC në sigurimin e mbështetjes jo-financiare për OSHC-të.

Nën-fusha 2.3: Burimet Njerëzore

Parimi: Politikat shtetërore dhe mjedisli ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizimin dhe angazhime të tjera me OSHC-të

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GUETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
